



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2019, ora 08:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Akademinë e Shkencave.
2. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me rektorët e universiteteve publike të Tiranës.
3. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me rektorët e universiteteve publike të rretheve.
4. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.
5. Miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, *komision për dhënie mendimi*.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Erion Piciri dhe Besnik Baraj(zëvendësues).

Mungojnë:

Fidel Ylli, Enada Kapllani, Selami Jenishehri, Amra Barova.

Të ftuar:

Skënder Gjinushi – Kryetar i Akademisë së Shkencave,

Vasil Tole – zëvendëskryetar në Akademinë e Shkencave,

Vjollca Xhamani – shefe e financave.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve.

Në mbledhjen e sotme kemi dëgjesa me institucionet e varësisë për diskutimin e projektbuxhetit të vitit 2020. Siç ramë dakord dje, në dëgjesën e orës 8:30 kemi të ftuar Akademinë e Shkencave.

Unë e fillova mbledhjen duke pasur parasysh që kohën që kemi në dispozicion duhet ta përdorim me efektivitet. Mbledhja mund të fillojë, sepse kuorumi është arritur, pra ne jemi më shumë se 11 veta në sallë. Në momentin që kryetarja do të vijë, pa dyshim që mund ta marrë drejtimin e mbledhjes së komisionit.

Zoti Gjinushi dhe zoti Tola, faleminderit që jeni prezent! Gjithashtu, ju falënderoj për dërgimin e kërkesave me shkrim që keni për buxhetin, por edhe për shpjegimin që keni bërë, duke e lidhur këtë kërkesë me ligjin e ri që rregullon veprimtarinë e Akademisë së Shkencave.

Ju lutem, prezantoni shkurtimisht nevojat tuaja për këtë shtesë në buxhetin e vitit 2020 dhe argumentojini me fakte të qëndrueshme. Gjithashtu, po ju vë në dijeni që komisioni në takimin e tij të radhës do të hartojë një relacion për Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, për veprimtarinë finale në përmirësim të projektbuxhetit të vitit 2020.

Komisioni ka caktuar si relatore zonjën Nikolla.

Fjala është për ju.

Skënder Gjinushi – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për mundësinë që më dhatë për të parashtruar projektbuxhetin tonë, për vitin 2020. Ne kemi sjellë një relacion shpjegues, por unë do t'i ritheksoj edhe një herë shkurtimisht kërkesat tona.

Akademia e Shkencave vitin që vjen fillon të punojë me ligjin e ri, i cili u bë i mundur edhe në sajë të kontributit dhe mbështetjes së komisionit tuaj, për të cilin ne ju jemi shumë mirënjohës. Ligji i ri parashikon disa ndryshime dhe detyra të reja për Akademinë e Shkencave.

Së pari, që në krye të ligjit të ri parashikohet që Akademia të luajë gjithnjë e më shumë rolin e saj në garantimin e gjuhës standarde në botimin e dokumentacionit kryesor, pikërisht në shërbim të punimeve, në drejtim të albanologjisë që lidhen ...

Fatjona Dhimitri – Zoti Gjinushi, më fal që po ju ndërpres...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që mund ta ndërpres. Unë kam njoftuar për vonesën në këtë komision sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, kam njoftuar shërbimet e komisionit, prandaj edhe mund të më prisnit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Gjinushi, me çfarë tagri keni ardhur këtu? Me çfarë statusi jeni këtu në këtë komision?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva, të lutem. Me çfarë statusi vini në këtë komision?

Skënder Gjinushi – Me statusin e kryetarit të Akademisë së Shkencave.

Fatjona Dhimitri – Me sa dimë ne, ju nuk jeni dekretuar, por jeni vetëshpallur.

Skënder Gjinushi – Tani vetëshpalljet janë bërë rutinë, prandaj nuk ka problem.

Fatjona Dhimitri – Vetëshpalljet janë të qeverisë moniste që ju kanë zgjedhur ju.

Skënder Gjinushi – Ku e mbani mend qeverinë moniste?

Fatjona Dhimitri – Patjetër, dhe ju jeni pjesëtar i asaj qeverie me këtë përzgjedhje që është bërë.

Skënder Gjinushi – Jeni shumë e vogël të mbani mend monizmin.

Fatjona Dhimitri – Zoti Gjinushi, ju nuk keni kompetenca të flisni në këtë komision. Shkresat që ju dërgoni në këtë komision janë të paligjshme, sepse vijnë nga një kryetar i vetëshpallur dhe jo i dekretuar.

Skënder Gjinushi – Ju nuk jeni gjykatëse...

Fatjona Dhimitri – Unë refuzoj të ulem me ju në të njëjtën tavolinë, sepse jeni turpi i shkencës këtu.

Skënder Gjinushi – Ju nuk jeni gjykatëse...

Milva Ekonomi – Për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Nuk ka fare për procedurë.

Milva Ekonomi – E para, nuk lajmërove fare ardhjen me vonesë.

Fatjona Dhimitri – Po, kam njoftuar shërbimet e komisionit për vonesën.

Milva Ekonomi – Unë të mora në telefon dhe nuk erdhe.

Fatjona Dhimitri – Përse po bëni avokatin mbrojtës për kryetarin e vetëshpallur?!

Milva Ekonomi – E para, nuk je korrekte me kohën që ka vendosur komisioni dhe ju e dini shumë mirë përgjegjësinë...

Fatjona Dhimitri – Kam njoftuar shërbimet e komisionit për vonesën për arsye personale.

Milva Ekonomi – Të lutem, më lini të mbaroj. E dyta, është e ndaluar të përdorni këtë gjuhë në këtë komision.

Fatjona Dhimitri – Jo, zotëria nuk mund të flasë në këtë komision.

Milva Ekonomi – Nuk mund të jetë kjo gjuha e përdorur në këtë komision nga kryetarja e komisionit.

Fatjona Dhimitri – Turpi i këtij komisioni është ardhja e këtij zotërie.

Milva Ekonomi – Ju duhet të rregulloni gjuhën dhe të keni kujdes kur flisni.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, ju pranoni të flisni me zotërinë që e keni zgjedhur vetë?

Milva Ekonomi – Ne e kemi për nder këtë gjë.

Fatjona Dhimitri – Jo, ky është turp i shkencës, madje edhe gazetarët e njohin se kush është zoti Gjinushi. Mund të vazhdoni vetë me drejtimin e komisionit.

Besnik Baraj – Zonjë, kam një fjalë për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është për të ardhur keq, por me sa duket dikush duhet t'i ketë thënë kësaj zonjuse apo zonje, nuk e di se çfarë statusi ka.

Milva Ekonomi – Përderisa është kryetare e komisionit, është zonjë.

Besnik Baraj – Që të ketë model të ngjashëm me Albana Vokshin. Është për të ardhur keq, sepse është vajzë e re dhe duhet të krijojë një profil sa më etik, që t'i përshtatet këtij komisioni.

Ajo u largua, por unë dua t'i them që të ketë kujdes për fjalët që përdor në drejtim të profesor Gjinushit, i cili është një nga personalitetet më të spikatur në fushën e shkencës dhe kontributeve politike. Unë e quaj nder që profesor Gjinushi është në krye të atij institucioni, që për vite me radhë është sfumuar nga politika dhe nuk ka arritur atë profil që kanë akademitë e vendeve fqinje. Unë jam shpresëplotë dhe i bindur që optika e profesor Gjinushit është e tillë që do ta ngrejë Akademinë në një status të ri, të krahasueshëm me akademitë e tjera, me dinjitet në të gjitha aktivitetet shkencore, politike të zhvillimit shkencor dhe politik të vendit dhe arsimit në përgjegjësi.

Ajo u largua dhe unë nuk e di se çfarë të them, sepse është për të ardhur keq që një vajzë e re tenton të prodhojë një profil shumë të deformuar, që opinionin publik tashmë e ka kontestuar në vite.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Baraj!

Zoti Gjinushi, të na falësh për ndërprerjen. Ne mendojmë se komisioni duhet të vazhdojë punën normalisht. Ne jemi shumë të lumtur që ju kemi sot për këtë dëgjese të buxhetit. Ne e dimë mënyrën se si keni menduar për të revizionuar të gjithë veprimtarinë e hartimit të buxhetit. Por në gjithë këtë proces transformimi të Akademisë së Shkencave, unë dua të

falënderoj të gjithë akademikët që na kanë mbështetur, veçanërisht zotin Tole, i cili nuk e ka humbur asnjëherë vëmendjen dhe angazhimin për të bërë më të mirën për ligjin e Akademisë, por edhe për këtë buxhet, të riparë dhe të revizionuar nga shërbimet e financës pranë Akademisë.

Fjala është për ju.

Skënder Gjinushi – Faleminderit edhe juve!

Hapësirat e para që ka ligji i ri janë pranimet e reja, por jo vetëm nga kërkuesit dhe shkencëtarët me banim në Shqipëri, pra që kanë kontribut brenda vendit, por edhe për ata jashtë vendit. Për këtë ne nuk kërkojmë rritje në buxhet, sepse titulli “akademik” është një titull nderi, që fitohet nga kontributi i kërkuesve në fusha të caktuara dhe ata nuk janë të punësuar në Akademinë e Shkencave, por marrin një honorar për titullin. Prurjet e reja, për pasojë rifreskojnë Akademinë, veçanërisht ata më të suksesshmit nga jashtë. Edhe me insistimin e komisionit është parashikuar që në 8 anëtarësimet e reja, 2 të jenë të përcaktuara për gjininë femërore, kjo për të rregulluar dhe mundësuar më mirë pranimin e dy gjinive, meqenëse Akademia është e zhbalancuar në këtë drejtim.

Milva Ekonomi – Faleminderit për këtë, sepse ne si komision jemi shumë sensitivë ndaj gjinisë.

Skënder Gjinushi – Pikërisht, prandaj dy vende janë të targetuara, ndërsa për 6 të tjerat konkurimi është i lirë. Por e theksoj se kjo nuk është bërë për favore, por oferta vjen nga ato fusha ku kandidatët janë parashikuar të jenë të gjinisë femërore dhe cilësia është absolutisht mjaft e lartë.

Për të vazhduar më tej, me ligjin e ri të Akademisë i vihet si detyrë garantimi i mbrojtjes së gjuhës standarde, zhvillimi i saj dhe në tërësi të gjithë fushës së albanologjisë. Për këtë arsye, Akademia e Shkencave duhet të bëjë disa botime të rëndësishme.

Së pari, duhet të funksionojë një këshill ndërakademik, i cili ka qenë, por duhet të ringrihet dhe së bashku me Akademinë e Kosovës të hartohet enciklopedia Shqiptare, historia e shqiptarëve dhe fjalori i madh i gjuhës shqipe. Pra, janë disa ndërmarrje të mëdha dhe rritja që ne kërkojmë shërben vetëm për të ngritur grupet e para, për të përcaktuar programin disavjeçar në hartimin e këtyre veprave madhore, pasi më tej do të duhet një koordinim më i mirë mes qeverisë sonë dhe asaj të Kosovës për të mbështetur këto vepra madhore.

Akademia e Shkencave vlerëson që duhet të ketë atë që i jep ligji, pra një rol prioritar dhe udhërrëfyes në fushat e reja të shkencës. Janë disa fusha, të cilat kanë një perspektivë të madhe, por te ne nuk janë në nivelin e duhur, ndonëse kemi specialistë shumë të mirë. Pra, kemi fushat e nanoteknologjisë, bioteknologjisë, gjenetikës, energjisë së rinovueshme,

inxhinierisë informatike, robotike e të tjera. Për të gjitha këto, ne parashikojmë të ngremë njësi të vogla. Pra, nuk pretendojmë të kalojmë menjëherë në nivele institutesh dhe qendrash të mëdha kërkimore, por të ngremë njësitë e para, pastaj së bashku me qeverinë do të vlerësojmë se cilat do të jenë masat e mëtejshme, që kërkimi në këto fusha të jetë të paktën në nivelin e rajonit. Kjo është një ndër arsyet që kërkohet një rritje në buxhet, në krahasim me buxhetin e mëparshëm.

Gjithashtu, ligji i ri parashikon që organika të bëhet në Kuvend, pra të miratohet nga ju dhe parashikohet të ketë një ndarje mes drejtimit shkencor të Akademisë nga drejtimi administrativ. Për këtë arsye, për herë të parë parashikohet kancelari, por krahas tij një nga të rejat e organikës është ngritja e një qendre monitorimi të projekteve. Pra, ligji i ri i kërkon Akademisë që të ketë një rol monitorues për të promovuar dhe nxitur kërkimin shkencor, veçanërisht në thithjen e projekteve. Me të drejtë kjo ka qenë një ndër kritikën kryesore që ka bërë qeveria ndaj Akademisë dhe kërkimit në përgjithësi, si institucion kërkimor, ku Shqipëria ka qenë mbrapa në thithjen e këtyre projekteve. Prandaj me ngritjen e një qendre të tillë, Akademia do të ishte një ndër koordinueset kryesore në thithjen e projekteve europiane dhe më gjerë në zhvillimin e shkencës te ne.

Të gjitha këto çojnë në një kërkesë minimale prej 20 milionë lekësh në raport me projektin e mëparshëm.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – A ka pyetje nga kolegët lidhur me prezantimin?

Po, Ismet.

Ismet Beqiraj – Profesor Gjinushi dhe profesor Tole, faleminderit!

Unë nuk kam ndër mend të kërkoj ndjesë ndaj atyre që përbaltin profesorët dhe akademikët, por në fillim të fjalës sime distancohem me neveri nga kjo gjuhë e rrugës dhe e shthurur. Prandaj ju nuk keni përse të shqetësoheni, sepse jeni në lartësinë e detyrës dhe institucionit që përfaqësoni. Jeni në lartësinë e përfaqësuesve të inteligjencës shqiptare, këtë e them si një ish-student juaji, ndërsa sot kam fatin të jemi kolegë në trupën akademike dhe krenohem që ju kam pasur pedagog dhe që keni shërbyer me kontributin tuaj.

Këto tensionime këtu janë bërë zakon, pra nuk i kemi vetëm me ju sot. Një Albanë ka ikur dhe një Albanë, pothuajse në nivele më të ulëta kredibiliteti dhe të gjuhës që përdor, e kemi në krye të këtij komisioni. Unë do t'i drejtohem kryesisht së komisionit dhe të gjithëve për zbatimin e Rregullores. Kur e shkel drejtuesja e komisionit, atëherë duhet të përballlet me të gjitha pasojat që Rregullorja e Kuvendit ka përcaktuar. Komisioni ynë me debate të tilla, nuk do të vazhdojë më.

Kërkesa që bëtë është simbolike. Hapësirat e reja që janë krijuar me miratimin e ligjit të ri, Akademia e Shkencave do të fillojë t'i implementojë, por projektet që keni bërë paraprakisht, ku do të ngrihen njësitë e kërkim-studimeve dhe, sigurisht, që duke pasur parasysh që Akademia dhe salla e Kuvendit janë nën të njëjtën çati, ka thënë kolegu ynë Nasufi, por Akademia është “ku thërret kiameti”, mos është simbolike kjo kërkesë që keni bërë, sepse ne si komision kemi vajtur në Akademinë e Kosovës dhe është si nata me ditën, duke filluar me ambientet, sallat dhe komforti që ka atje. Prandaj më duket simbolikë kërkesa dhe ne si komision do të sugjerojmë t'i rishikoni edhe një herë këto kërkesa tepër simbolike dhe modeste.

Skënder Gjinushi – Ne kemi kërkuar vetëm shtesë për të filluar punën në drejtimet e reja që na jep ligji, për ngritjen e njësive dhe ngritjen e njësisë së projekteve. Pra, që Akademia të marrë rolin nxitës dhe drejtues në fushat ku mungojnë institute, ndërkohë që rajoni ka institute, si për nanoteknologjinë, bioteknologjinë e me radhë.

Ndërsa për kushtet e Akademisë, kërkesat janë shumë të mëdha dhe këto do t'i ngelen një të ardhme. Për këtë vit të parë ne nuk kemi kërkuar tjetër, përveç përmirësimit të ndonjë emergjence, sepse mendojmë të fillojmë punën, pastaj të justifikojmë mbështetjen logjistike në infrastrukturë. Meqenëse në ligjin e ri parashikohet që një herë në vit të ketë një dialog me qeverinë, ne do t'ia parashtrojmë qeverisë për të pasur një paketë më serioze, pra nuk do t'ia kërkojmë Kuvendit.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Gjinushi!

Kështu e përkthyer edhe ne shkresën që ju dërguat, pra që ju po bëni transformimet e nevojshme brenda këtij buxheti, për të qenë në një linjë me ligjin e Akademisë së Shkencave. Edhe pjesa e dialogut ka qenë një nga pjesët që ne kemi diskutuar gjatë miratimit të ligjit, i cili është shumë i rëndësishëm, sepse varet shumë edhe nga drejtimi i zhvillimit ekonomik, por edhe për të hapur mënyrën e diskutimit për gjërat shkencore, që i shërbejnë prodhimit në Shqipëri, pra ka nevojë që të ketë një diskutim me qeverinë për këto gjëra.

Unë mendoj se me këtë kërkesë e kemi ezauruar dëgjuesën me Akademinë e Shkencave.

Ju falënderojmë për gatishmërinë edhe me ndryshimin e orarit në ditën e sotme! Gjithashtu, duam t'ju kërkojmë ndjesë, sepse komisioni në përgjithësi, pavarësisht nga anët e tavolinës, mendon që Akademia e Shkencave është një institucion i rëndësishëm në Republikën e Shqipërisë dhe duam të respektojmë edhe veprimtarinë e saj.

Faleminderit!

Skënder Gjinushi – Faleminderit edhe ju!

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Sinqerisht, kjo vlerë që këta kërkojnë më duket shumë e vogël, sepse ambicia është shumë e madhe.

Milva Ekonomi - Këtë tha edhe profesori, që do të bëjë një paketë ndryshimesh në Akademi. Ai tani po rregullon sipas ligjit vetëm strukturën e funksionimit të Akademisë, por tha se do të bëjë edhe një paketë për të gjitha ndryshmet që kërkohen të bëhen në Akademi, ndaj sot nuk është ky objekti i diskutimit.

Besnik Baraj – Megjithatë, unë mendoj se zonja Lindita ka punuar në këtë fushë dhe ka drejtuar një nga problemet e mëdha të zhvillimeve në Shqipëri, që është mungesa e kapaciteteve të integruara për përshkrimin e projekteve. Ne kemi të fragmentarizuar në universitete individë, të cilët aplikojnë, e të tjerë, por ajo që rëndon më shumë është se nuk ka një qendër që të integrojë dhe mundësitë financiare për të marrë nga BE-ja apo nga institucionet e tjera ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, unë mendoj se duhet t'i japim një mbështetje më të madhe që kjo qendër të ngrihet sa më shpejt dhe të mos jetë më si një vit më parë. Kur të miratohet buxheti tjetër, ne të bëjmë të mundur që ta ngremë këtë qendër. Sidoqoftë, ju e dini vetë, por mendoj se nuk është ndonjë gjë e madhe, në qoftë se nga 20 ta bëjmë 40 milionë lekë.

Milva Ekonomi - Së pari, duhen edhe 20 milionë të tjera, gjë të cilën ne nuk e dimë nëse realizohet.

Së dyti, besoj se ju e dini shumë mirë, pasi vini nga Komisioni i Ekonomisë, që është më i vështirë për të dialoguar. Ne kemi përgatitur një drafttabelë, së bashku me Linditën, ku paraqiten të gjitha kërkesat që kanë institucionet e varësisë në këtë komision.

Besnik Baraj – Kjo vlerë është shumë e vogël në raport me buxhetin që këta kanë nevojë.

Milva Ekonomi – Patjetër, ne mund ta shikojmë këtë pjesë.

Fjala e fundit është për ju, zoti Kostaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirëmëngjesi përfaqësues të universiteteve dhe mirë se keni ardhur!

Ju lutem, na jepni një minutë kohë, para se të kalojmë te çështja e buxheteve tuaja.

Kostaq Papa– Faleminderit, zonja nënkryetare!

Zoti Baraj, ne nuk reaguam për shkak se sot nuk kemi kohë për të folur për këtë çështje, ndaj u morëm vetëm me buxhetin. Në fakt, dihet se ka një ngërç qoftë politik, qoftë juridik, megjithatë çdo reagim që bëhet në komision, çdo reagim që bëhet në parlament, bëhet nëpërmjet votës. Nëse në një moment tjetër problematika apo ngërçi i Akademisë vjen në

parlament, ne do të reagojmë nëpërmjet votës. Kështu që nuk po futemi te pjesa jetike, të cilën të gjithë e duam që të jetë në nivelin më të lartë, ndaj duhet të pranojmë, reagimi im duhej të ishte direkt pas fjalës suaj, që sot bëme disa tolerime, për shkak se diskutimet e sotme janë për buxhetin, një çështje e rëndësishme, e cila kërkon shumë kohë dhe kujdes për t'u trajtuar, pasi janë shumë zëra dhe publiku, qytetarët presin paratë e tyre për vazhdimësinë e jetës për një Shqipëri më të mirë dhe për një të ardhme më të mirë për brezat.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2.Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me rektorët e universiteteve publike të Tiranës.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Erion Piciri dhe Besnik Baraj(zëvendësues).

Mungojnë:

Fidel Ylli, Enada Kapllani, Selami Jenishehri, Amra Barova.

Të ftuar:

Anila Bulo - zëvendësrektore e Universitetit të Mjeksisë,

Andi Mahila - administrator i Universitetit të Mjeksisë,

Gentiana Keraj - zëvendësrektore e Universitetit të Tiranës,

Agron Çuka – Rektor i Universitetit të Sporteve,

Mirlinda Galushi - administratore e Universitetit të Sporteve.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Mirë se keni ardhur!

Në fakt, është kënaqësi sa herë që kemi përfaqësues të universiteteve në komisionin tonë, sepse diskutojmë jo vetëm për buxhetin, por edhe për të tjera çështje që na shqetësojnë në përgjithësi. Vitin e kaluar ju kërkuat që në këtë dëgjese të mos ishin prezentë vetëm rektorët, por edhe administratorët, ndaj komisioni ynë këtë vit e mori në konsideratë kërkesën tuaj dhe u ka bërë ftesë rektorëve të universiteteve që në mbledhje të vinin së bashku me administratorët. Kështu që ju falënderoj për kërkesën tuaj, por edhe për angazhimin e sotëm.

Unë tani do të ulem në vendin tim, pasi mbledhjen do ta drejtojë kryetarja e komisionit.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit për prezencën tuaj!

Atëherë, të ftuar nga Universiteti i Mjekësisë kemi prof.dr., zonjën Anila Bullo dhe administratorin, zotin Andi Mahila. Nga Universiteti i Tiranës kemi zëvendësrektorin, zonjën Gentiana Keraj dhe administratorin, zotin Skerdi Dafa. Nga Universiteti Politeknik...

Muhamet Bela – Këta e kanë dërguar relacionin me shkrim.

Fatjona Dhimitri – Pra, i kanë dërguar informacionet me shkrim.

Nga Universiteti Bujqësor, a janë dërguar materialet me shkrim?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nga Universiteti i Sporteve kemi prof.dr., zotin Agron Çuka dhe administratorin, zonjën Mirlinda Galushi.

Atëherë, fjalën po ia jap rektorit të Universitetit të Sporteve.

Agron Çuka - Faleminderit për ftesën!

Sigurisht, nuk është hera e parë që ne jemi këtu. Ky komision ka bërë edhe një vizitë në ambientet e universitetit tonë dhe i ka parë nga afër problematikat që kemi, por ne do të fokusohemi te problemet e buxhetit.

Aktualisht këtë vit kemi hapur një fakultet të ri, që sigurisht do të kërkojë financim nga buxheti. Ne kemi planifikuar që ky fakultet të plotësohet për 3 vjet, kështu që për këtë vit janë planifikuar të rekrutohen vetëm 6 pedagogë të rinj dhe pjesa tjetër do të plotësohet me pedagogët e brendshëm. Kështu, në aspektin e buxhetit, mendoj se kjo nuk do të jetë një ngarkesë e madhe.

Në historinë 60-vjeçare që ka institucioni ynë, ne gjithmonë jemi trajtuar si të veçantë në aspektin e fondit të pagave, jemi trajtuar gjithmonë si të veçantë për karakteristikat që ka institucioni ynë, në kuptimin e ndërtimit të grupeve mësimore dhe ngarkesave që kanë

pedagogët, pra gjithmonë jemi trajtuar me një koeficient 3,9. Unë nuk i di hollësitë ekonomiko-financiare se si përcaktohen koeficientët, por di se gjithmonë jemi trajtuar me këtë koeficient për sa i përket buxhetit të caktuar për ne. Nuk po futem shumë në detaje, pasi për shifra dhe gjëra të tjera do të flasë administratorja.

Një problem të rëndësishëm që ne kemi, të cilin ju e konstatuat vetë kur erdhët në institucionin tonë, ka të bëjë me investime në ambiente. Sigurisht, kërkohen investime të mëdha, pasi stadiumi i universitetit është dëmtuar shumë nga ndërhyrjet e ndërtimeve pa leje. Ne i kemi dërguar Ministrisë së Arsimit hartën e institucionit tonë që të hipotekohet, mirëpo ka kaluar gati një vit që kjo çështje ka shkuar në Ministrinë e Brendshme, pasi duhet ndjekur kjo linjë që Ministria e Arsimit ia kalon Ministrisë së Brendshme dhe këta të fundit e dërgojnë në hipotekë dhe më pas të kthejnë përgjigje. Aktualisht ne nuk kemi marrë asnjë përgjigje, ndaj nuk kemi mundur që të investojmë dhe t'i rregullojmë ambientet tona. Pra, stadiumi është një investim shumë i madh, por ka edhe disa ambiente të tjera që duhen rregulluar, për të cilat ne kemi dërguar një raport me shkrim. Për këtë do të flasë administratorja, pasi ajo i ka me shifra, por, mendoj se kjo çështje duhet parë me kujdes, pasi po dëmtohet mësimi. Faktikisht këto ambiente të mëdha shfrytëzohen edhe për stërvitje nga ekipet, duke e ndihmuar edhe sportin, por, në radhë të parë, do të na shërbenin shumë për mësimdhënie.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, profesor!

Fjalën e ka administratorja.

Mirlinda Galushi – Faleminderit, për ftesën!

Në fakt, ne kemi qenë këtu edhe vitin e kaluar për pjesën e buxhetit. Universiteti i Sporteve është i veçantë, në krahasim me universitetet e tjera. Normalisht të gjitha universitetet kërkojnë më shumë fonde, pasi janë më të mëdha se ne, kurse ne jemi më të vegjël, në krahasim me to, por jemi më të veçantë. Pothuajse të gjitha projektet e investuara në universitetin tonë kanë përfunduar. Një nga projektet, që nuk ishte përfunduar ende vitin e kaluar, pra bëhet fjalë për fushën e futbollit, u përfundua sivjet dhe tani e kemi marrë në dorëzim. Pjesa kryesore e të ardhurave të universitetit ka shkuar për investime, pasi, të themi të drejtën, fondin e buxhetit për të financuar pagat e stafit akademik dhe administrativ e kemi pasur të plotë deri në fund të vitit. Kështu, kjo e ka ndihmuar universitetin që pjesën më të madhe të të ardhurave ta kalojë për investime, për blerje pajisjesh laboratorike ose në funksion të palestrave dhe ambienteve sportive. Për vitin e ardhshëm ne kërkojmë të bëhen të gjitha investimet, të cilat kemi vite që i kërkojmë, në mënyrë që arrijmë planin strategjik të miratuar nga bordi i administrimit të universitetit. Në qoftë se do të financohen këto projekte, atëherë kompleksi i këtij universiteti

do të quhet i plotësuar dhe do të krahasohet me projektet e universiteteve europiane, të cilat i kemi vizituar. Pra, në qoftë se do të financohen fusha e futbollit, pista e atletikës, pishina, shtesa e gjimnastikës, të cilat janë projekte kryesore, kompleksi i Universitetit të Sporteve do të jetë i plotësuar. Ndryshe nga universitetet e tjera, godinat dhe ambientet tona janë në të njëjtin vend dhe për t'i realizuar të gjitha këto projekte, siç e tha edhe rektori, më parë ne duhet që të kemi inventarizimin e pronave, në mënyrë që të marrim lejet e ndërtimit për këto rikonstrukcione ose ndërtime që do të bëjmë.

Ne kemi parashikuar që një pjesë të këtyre ndërtimeve t'i financojmë me të ardhurat e universitetit. Për shembull, pista dhe fusha e futbollit janë urgjente për t'u rikonstruktuar për arsye se kanë të bëjnë direkt me procesin mësimor, pasi pjesa më e madhe e dy fakulteteve e zhvillojnë procesin mësimor në këto ambiente. Një pjesë nga ju ishit për vizitë në universitetin tonë dhe i ka parë se si zhvillohet mësimi në ato ambiente, gjë që nuk është normale. Duke qenë se këtë projekt ne e kemi gati, kërkojmë që një pjesë të këtij projekti të financohet nga buxheti dhe pjesa tjetër është parashikuar që të financohet nga të ardhurat e universitetit. Ky është prioriteti i parë për Universitetin e Sporteve për vitin 2020, kurse prioriteti tjetër është rikonstrukcioni i palestërës së gjimnastikës, e cila duhet bërë për arsye se kemi ankesa nga studentët. Kjo palestër është rikonstruktuar që në vitin 2000 dhe që nga ajo kohë kemi pasur shumë kërkesa për ta rikonstruktuar, por tani realisht ne kemi gati një projekt për të bërë një shtesë në këtë palestër, e cila do të kushtojë 31 milionë lekë të rinj.

Lidhur me fushën e futbollit dhe me pistën e atletikës, ne kemi parashikuar që një pjesë të financohet nga të ardhurat e universitetit, që janë gati 99 milionë lekë.

Për sa i përket pishinës është normale që është një investim shumë i madh për buxhetin. Të themi të drejtën, kërkesa që ne kemi bërë për këtë investim është gati sa gjysma e buxhetit të parashikuar, pasi është një investim shumë i madh. Për pishinën kërkohet një financim shumë i madh, gati 313 milionë lekë të rinj, ndaj ne kemi kërkuar që ky financim të ndahet në vite, ndoshta në 3 vjet, për t'u përfunduar. Këto investime do të mbyllnin totalisht ciklin e këtij kompleksi që do t'u shërbente studentëve; stafit akademik; do të përmirësonte infrastrukturën, si dhe do të plotësonte standardet, duke u krahasuar me universitetet europiane. Në qoftë se do të kryheshin të gjitha këto investime, atëherë besoj se në vitet në vijim ato do t'i nxjerrin të ardhurat e tyre. Realisht mirëmbajtja e këtyre ambiente do të kërkonte kosto shtesë, por ato mund të jepen në shërbim të të tretëve dhe të ardhurat të përdoren për mirëmbajtje. Kjo gjë është realiste, për arsye sepse ne kemi një palestër të madhe që realisht e japim në shërbim të të tretëve pasdite, gjë që na ka shërbyer për mirëmbajtjen e saj, madje me këto të ardhura ne do ta rikostruktojmë këtë palestër. Pikë kryesore është edhe pjesa e buxhetit

për fakultetin e ri që ne kemi parashikuar dhe pjesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore, por pjesa kryesore janë investimet.

Milva Ekonomi – Sa është vlera?

Mirlinda Galushi – Unë kam dhënë një vlerë të relacioni, që është gati 307 milionë për vitin 2020 dhe, më pas, pjesa tjetër është lënë për vitin 2021.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Vijojmë me zonjën Gentiana Keraj nga Universiteti i Tiranës.

Gentiana Keraj – Të nderuar anëtarë të komisionit, faleminderit për ftesën për të qenë këtu sot.

Unë nuk dua të futem shumë në shifra lidhur me buxhetin e Universitetit të Tiranës, sepse këtë gjë e bën administratori, por besoj se do t'ju vijë edhe një relacion me shkrim nga Universiteti i Tiranës. E rëndësishme për t'u theksuar është mbështetja për studiuesit e rinj dhe kjo nënkupton mbështetje për programet e doktoraturës. Për shkak të ndryshimeve të ligjit të ri, është e nevojshme që studentët e doktoraturës të punësohen në projekte të ndryshme. Kjo është e vështirë të ndodhë në rast se nuk rritet buxheti i parashikuar për kërkimin. Me sa kam parë unë në projektbuxhet nuk është parashikuar ndonjë rritje fondi për projekte që menaxhohen nga AKSH-i. Në këtë kuadër, do të ishte e nevojshme që të ketë parashikime të veçanta për programet e doktoraturës, sepse, në fund të fundit, kjo i shërben edhe realizimit të objektivave që janë parashikuar në buxhet për periudhën 2019-2022 në lidhje me rritjen e numrit të kërkuesve. Sigurisht është e rëndësishme që të vihet theksi te gradat dhe titujt, në mënyrë që në 3 vjetët e ardhshëm ne të kemi një numër më të madh të pedagogëve me grada dhe tituj doktrature të punësuar në departamente. Ky është hapi i parë dhe më i rëndësishmi në këtë drejtim, kështu që do të ishte një kërkesë nga Universiteti i Tiranës që të bëhen parashikime konkrete në këtë drejtim dhe brenda mundësive të rritet fondi për projekte kërkimore në buxhetin total. Sivjet kishte një fond për projektin infrastrukturor nga Ministria e Arsimit, ku Universiteti i Tiranës përfitoi disa projekte. Gjithashtu, janë të planifikuara edhe shumë projekte të tjera, por, sigurisht, kanë nevojë dhe bashkëfinancim me fondet publike dhe të ardhurat që ka universiteti. Unë do të theksoj pikërisht aspektin e programeve të doktoraturës, si një moment shumë të rëndësishëm, duke pasur parasysh që prej disa vjetësh në universitetet publike nuk po pranohen studentë të rinj në programet e doktoraturës.

Faleminderit.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

A mund ta marrë fjalën administratori?

(Ndërhyrje pa mikrofoni.)

Administratori nuk është.

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, a mund të shtoj diçka për procedurë?

Fatjona Dhimitri - Po.

Milva Ekonomi – Unë do t'i lutesha përfaqësueses së Universitetit të Tiranës, edhe për arsye të kërkesave që vijnë nga komisioni, por edhe për arsye të kërkesës që keni bërë ju vetë si universitet, që administratori të jetë prezent. Unë e kuptoj se ai mund të ketë angazhime të vendosura më parë në kohë, por materiali shkrimor, patjetër duhet të vijë me *email* në sekretari.

Gentiana Keraj – Po, këtë do ta thosha pak më vonë.

Milva Ekonomi – Unë do t'ju lutesha shumë që ta bëni këtë gjë brenda ditës së sotme, pasi është një material i gatshëm. Unë mendoj se, përderisa keni punuar për buxhetin, këto gjëra i keni të gatshme.

Fatjona Dhimitri – Viojmë me përfaqësuesit e Universitetit të Mjekësisë.

Po, zonja zëvendësrektore.

Anila Bullo – Faleminderit për ftesën dhe për vëmendjen tuaj!

Unë dua të bëj një paraqitje të shkurtër të situatës dhe të kërkesave që ka Universiteti i Mjekësisë, i cili, po ashtu, ka specifikat e tij dhe si ëmbëlsirë që është mbeti për në fund.

Shkurtimisht po lexoj materialin që kam dërguar, në mënyrë që të jem sa më koncize dhe t'ju marr sa më pak kohë.

Universiteti i Mjekësisë Tiranë është institucion i asimit të lartë, i cili është themeluar në vitin 1952 dhe është organizuar më pas në vitin 1957 në formën e Fakultetit të Mjekësisë pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Në vitin 2013, si pasojë e një riorganizimi, me VKM-në nr. 48, ky institucion mori statusin e një universiteti më vete dhe ushtron veprimtarinë e tij, bazuar në ligjin e arsimit të lartë në vitin 2015.

Gjatë vitit 2019 ky universitet hartoi programin buxhetor afatmesëm 2020-2021, të cilin e shoqëroi me një proces gjithëpërfshirës të stafit akademik, stafit administrativ dhe këshillave studentorë. Ky dokument, pas miratimit në organet kolegjiale, u dorëzua në Ministrinë e Arsimit brenda afateve ligjore. Me anë të parashikimeve në buxhetin e vitit 2020 dhe të dy vjetët 2021-2022 synohet të plotësohen objektivat e misionit të zhvillimit strategjik të universitetit.

Gjatë hartimit të programit buxhetor për vitin 2020 janë mbajtur parasysh plotësimet e kërkesave të studentëve, sidomos të atyre të paraqitura gjatë periudhës dhjetor 2018 - janar

2019, si dhe zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga paketa për arsimin e lartë, miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Për vitin 2019, në kuadër të paketës për arsimin e lartë, universiteti u financua me grant nga buxheti i shtetit për rreth 79 milionë lekë për mbulimin e 50% të tarifës së shkollimit për studentët e ciklit të parë dhe të integruar të studimit. Dua t'ju them se ky material është një material i përgatitur nga administratori dhe rektori dhe unë po jua lexoj, por, në fakt, është një material yni i përbashkët.

Duke evidentuar faktin, që si pasojë e kërkesës së lartë që ka për të ndjekur programe të integruara të Universitetit të Mjekësisë nga ana e studentëve ose e maturantëve me mesataren më të lartë, që përfundojnë maturën shtetërore, rreth 98% e maturantëve, të cilët më pas shndërrohen në studentë, përfitojnë bursa nga shteti për shkak të mesatares shumë të lartë. Fondet për bursa të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2019 kanë qenë rreth 115 milionë lekë. Granti mësimdhënës për vitin 2019 për universitetin mbulon jo të gjithë vitin akademik me paga dhe sigurime shoqërore dhe për pasojë një pjesë e vitit duhet të përballohet nga të ardhurat që siguron vetë universiteti.

Në politikën e mbledhjes së të ardhurave Universiteti i Mjekësisë së Tiranës ka ndjekur politikën e mosrritjes së tarifave të studimit për programet studimore të ciklit të dytë dhe të tretë, edhe për vitin akademik 2019-2020, duke mbajtur të njëjtin nivel tarifash. Po ashtu heqja e të gjitha tarifave për shërbimet ndaj studentëve në këtë institucion, sigurisht që e ka kufizuar buxhetin e siguruar nga të ardhurat që siguron universiteti në vijimësi.

Në kuadër të paketës për arsimin e lartë në Universitetin e Mjekësisë së Tiranës gjatë viti 2019 kemi përfituar fonde nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor në dy projekte të infrastrukturës. Po ashtu vlen të theksohet që në kuadër të Paktit për Universitetin, Ministria e Shëndetësisë dhe e Përkrahjes Sociale në patronazhimin e saj ka ofruar mbështetje të rëndësishme financiare, për financimin e Qendrës së Stimulimit Klinik e përbërë nga 4 laboratorë klinikë, që përbëjnë një vlerë thelbësore dhe do ta përmirësojnë ndjeshëm cilësinë dhe standardin e sistemit akademik për profesionistët e shëndetësisë në të gjitha fakultetet e Universitetit të Mjekësisë.

Vlen të theksohet që Ministria e Shëndetësisë na ka mbështetur financiarisht jo vetëm me këto projekte, por vijon të na mbështesë edhe me projekte që kanë lidhje me mobilitetin e studentëve. Deri tani kanë lëvizur përmes saj dhe janë trajnuar jashtë vendit mbi 30 studentë, për probleme të rëndësishme të shëndetit publik dhe Ministria e Shëndetësisë ka qenë përherë dhe vazhdon të jetë, edhe në projektet në të ardhmen në të ardhmen, një mbështetje e fuqishme edhe financiare për Universitetin e Mjekësisë.

Zhvillimet e vrullshme teknologjike dhe standardet e larta në mësimdhënie dhe kërkim shkencor për universitetet mjekësore bëjnë që kërkesat për laboratorë mësimdhënës, ambientet studimore, laboratorët kërkimorë shkencorë e të tjera duhet të zgjerohen në vijimësi. Po ashtu, rritja e kërkesave nga sistemi shëndetësor shqiptar, për rritjen e numri të profesionistëve në shëndetësi, sidomos mjekë, i bën të domosdoshme investimet e vazhdueshme dhe rritjen e kapaciteteve infrastrukturore të Universitetit të Mjekësisë së Tiranës. Rritja e shërbimeve cilësore ndaj studentëve, si dhe plotësimi i kërkesave në rritje të stafit akademik në respekt të plotësismit të misionit të tyre bën që nevojat financiare të Universitetit të Mjekësisë të jenë në rritje të vazhdueshme.

Sa më sipër, kërkojmë vëmendjen tuaj për ta mbështetur universitetin tonë në mbulimin e plotë, gjithëvjeçar, të pagave dhe sigurimeve shoqërore, në mbështetjen financiare për përmirësimin e infrastrukturës të dy fakulteteve tona, të Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, të cilat sigurisht do ta rrisin cilësinë akademike në ndihmë të një standardi më të lartë të përgatitjes së studentëve tanë për këto dy fakultete, por jo vetëm.

Faleminderit!

Jemi të hapur për çdo pyetje.

Fatjona Dhimitri – Dëshironi të bëni ndonjë pyetje?

Urdhëroni.

Erion Piciri – Është kënaqësi të kemi të pranishëm në komision përfaqësuesit e universiteteve shqiptare. Kam diçka, të cilën e bluaj prej shumë vitesh. Mbrëmë po shihja rankimet e universiteteve ballkanike për të parë se ku qëndronte universiteti shqiptar. Pashë që Universiteti i Athinës ishte diku te 501 deri 600 *Times Higher Education*, i Lubjanës 601 deri në 800, i Bukureshtit, Beogradit dhe Stambollit ndodheshin nga 800 deri në 1000, i Zagrebit, Sofjes dhe i Malit të Zi nga 1000 e diçka, ndërsa Universiteti i Tiranës, nuk më doli fare. Unë mendoj që kjo është një dramë kombëtare dhe që këtu duhej të niste diskutimi mbi buxhetin.

Universiteti i Tiranës më del në një *unirank* jo shumë serioz, i 7376-i, ndërsa Universiteti i Mjekësisë, që përfaqësoni ju, zonjë, më del vetëm *Uebo Metrix* i 20008. Unë prisja që ju të kërkonit më shumë para nga buxheti i shtetit, sepse çështja esenciale në kuadër të universiteteve sot është që ose nuk kemi burime njerëzore cilësore, ose nuk kemi para t'i menaxhojmë. Problemi që unë shtroj ka të bëjë me faktin që sa më i lartë të jetë buxheti i universiteteve tuaja, të paktën të arrijmë vendet Ballkanike, të jemi ndër 1000 universitetet e para të kësaj bote. Një ndër shkaqet pse studentët largohen, si dhe mjekët që punojnë në mbarë

Europën, është cilësia e dobët e universiteteve, por edhe e konkurrencës dhe e shumë elementeve të tjera.

Para 1 viti, kur pati një presion nga ana e studentëve, u gjetën paratë nga buxheti i shtetit. Pra, nëse do të vijë një presion nga bota universitare, do të ndryshojë arsimi, jeta e kombit dhe do të kemi të tjera perspektiva.

Zonja, si përfaqësuese e Universitetit të Tiranës foli diçka në lidhje me doktoraturat, por nuk na dha ndonjë përqindje apo shifër, 5 apo 10 herë më të lartë. Ai dekalazhi i lartë që ekziston ndërmjet arsimit shqiptar dhe arsimit të vendeve të tjera, mendoj se do të vijë ndonjë moment, sepse janë pedagogët dhe përfaqësuesit e universiteteve ata që mund t'i bëjnë një presion kësaj qeverie apo çdolloj qeverie, që të marrin më shumë fonde dhe arsimi të ecë përpara. Jemi një ndër vendet me arsimin më të dobët në Europë, ndoshta nga më të dobëtit në botë. Kjo është diçka serioze edhe pse u bëmë 100 vjet shtet.

Do të doja të dija nga ju sa më të madh e doni arsimin? Po të shkojmë me këtë ritëm, në mënyrë të vazhdueshme do të kemi të njëjtin arsim siç e kemi pasur dhe një ikje masive të të rinjve.

Kam disa të dhëna të INSTAT-it, në të cilat thuhet se kemi humbur 25 mijë studentë nga viti 2014 deri në vitin 2019. Ka një fondacion gjerman socialdemokrat, nuk po ia mbaj mend emrin, i cili thotë se nga këta 25 mijë studentë që janë larguar për në Europë, 94% e tyre nuk duan të kthehen më në Shqipëri. Kjo është një ikje e madhe e potencialit financiar të familjeve shqiptare, sepse nëse do të kishin një menaxhim më të mirë si në nivelin e ministrive, edhe të qeverisë, por edhe një presion më të madh nga universitetet, do të ishim atje ku duhet që këto para të mos iknin nga vendi. Një fëmijë, i cili shkon në Europë, financohet nga familja për 4-5 vjet me një shumë prej 80-100 mijë eurosh. Imagjino për 25 mijë studentë!

Ky është një diskutim i madh dhe sot në komision duhej të bëhej një luftë shumë e madhe për fondet, si dhe një presion, në mënyrë që këto çështje të bëhen mediatike, pasi opinioni publik gjithmonë është një faktor i rëndësishëm që e mbështet një çështje të tillë. Dje, kur diskutuam për shifrat, doli se 2,2% jepet për arsimin, jo për arsimin e lartë, sepse për të është 0,5%, por për arsimin në përgjithësi, në një kohë që vendet e OECD-së e kanë diku te 4,5%, ndërsa vendet e Bashkimit European 4,7%. Ne investojmë 570 dollarë për nxënës dhe student, ndërsa vendet e OECD-së 10 800, sepse edhe kërkimi kërkon para, kërkon një karrierë të konsoliduar, ku politika të mos i fusë duart, një menaxhim më të mirë. Nuk shoh nëse keni ndonjë zë, që një pjesë e pedagogëve dhe e kërkuesve shqiptarë të shkojnë dhe të arsimohen në universitetet më të mira dhe kjo të paguhet nga buxheti i shtetit, në mënyrë që ata të kthehen.

Mbaj mend një fjalim të Netanjahut në OKB: “Na thoni komb inovacioni dhe realisht ashtu jemi. Para dy javësh më erdhi Kryeministri i Indisë dhe e dërgova në një shëtitje buzë detit, morëm 1 litër ujë dhe e dërguam te kërkuesit tanë dhe për 1 orë na e dhanë ujë të pastër. Këta jemi ne, njerëzit e shkencës dhe të kërkimit, kështu na njeh e gjithë bota”.

Pra, këta njerëz që bëjnë diçka të tillë, ushtrojnë një presion ndaj qeverive. Nëse mban marrëdhënie të mira me qeverinë, ndoshta për karrierë apo hierarkinë universitare, nuk shkojmë askund, sepse ky popull ka nevojë të shkundet dhe kjo shkundje duhet të vijë pikërisht nga bota universitare, sepse nëse ka njerëz me mend dhe të lirë në këtë botë është pikërisht universiteti.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

A dëshiron ta shprehë opinionin e tij administratori i Universitetit të Mjekësisë lidhur me buxhetin?

Andi Mahila – E nderuar kryetare e komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Faleminderit për ftesën dhe mundësinë për të shprehur kërkesat dhe për të ndarë së bashku nevojat që ne kemi!

Materialin që ju kemi dërguar, i cili është paraqitur nga ne si Universiteti i Mjekësisë së Tiranës është i përbashkët, në kuptimin që shqetësimet te ne ndahen bashkë, e cila kap pjesë, që i ngrihet edhe deputeti që u shpreh pak më parë, por edhe çështje të buxhetit.

Duke mos dashur të përsëris ato që tha profesoreshë Bullo, në mënyrë koncize dua të konkretizohem te buxheti pa kaluar te diskutimet e tjera. Ne si universitet kemi përgatitur programin buxhetor afatmesëm 2020-2022, ku sipas procedurave të përgatitjes së buxhetit në këtë material paraqiten të gjitha kërkesat dhe nevojat që ne kemi. Materiali është miratuar dhe është depozituar në Ministrinë e Arsimit, e cila e ka pasur parasysh në kërkesat që ka bërë në Këshillin e Ministrave për përfshirjen e kërkesave tona, si Universiteti i Mjekësisë, në buxhetin e vitit 2020. Sa janë këto kërkesa të përfshira, kjo është diçka që nuk mund t’ju jap një përgjigje, sepse zërat e buxhetit të shtetit që dalin nuk janë kaq të detajuara gjërat që ne kërkojmë, pastaj është çështja e granteve e të tjera me radhë.

Është për t’u theksuar që viti 2019 pati një karakteristikë, e cila ndikoi te financat, sidomos pas lëvizjes studentore në muajt dhjetor-janar u mor përsipër nga qeveria shqiptare përballimi i bursave 100%, duke rritur marzhin e studentëve të ekselencës, para dhjetorit ishte vetëm për ata me mesatare 10, ndërsa tani përfshihen studentët me mesatare nga 9 deri në 10. Ky fakt për Universitetin e Mjekësisë do të thotë që i gjithë viti i parë i studimeve të mjekësisë, për shkak të nivelit të lartë të studentëve që përfitojnë studimet në këtë universitet, si dhe të

kërkesave dhe të procedurës që ka përcaktuar vetë universiteti, është i përjashtuar nga tarifat e studimit dhe përveç kësaj paguhen edhe me një bursë prej 10 mijë lekësh në bazë të VKM-së. E gjithë kjo zbritet nga të ardhurat dytësore të universitetit, por siç e kemi paraqitur edhe në material 115 milionë lekë në vlerë nominale, e cila është gati 60% e vlerës së munguar, është rimbursuar nga shteti gjatë vitit 2019.

Marrëdhënia e marrjes dhe e shlyerjes së detyrimeve ka funksionuar deri në këtë pjesë, pa futur këtu edhe 79 milionë lekë të tjera, të cilat janë përdorur për uljen e tarifës për studentët në nevojë dhe për kategori të ndryshme që përcaktohen nga ligji. Kjo gjë ndodh pikërisht në të njëjtin moment kur universiteti ynë nuk ka ndryshuar nivelin e tarifave për studentët.

Është e vërtetë që në pjesën e rankimeve mund të mos jemi ose jemi shumë larg, por pa dashur të jap përgjigje shteruese, dua ta kap në këndvështrimin që ndoshta rankimi është në raport të drejtë edhe me pjesën e buxhetit që thoni ju. Dua të di, që këto universitete janë shtetërore, jemi duke u krahasuar me të njëjtin lloj apo krahasimi, është shtetëror-privat? Vetëm brenda Shqipërisë një universitet shtetëror e ka tarifën 20 mijë lekë, kurse një universitet privat e ka 2 mijë euro...

(Diskutime pa mikrofon)

Më kuptoni drejt, nuk e kam me ju, por me faktin që pjesa financiare është shumë e rëndësishme. Jemi duke diskutuar për universitetet publike, por mendoj që krahasimet na bëjnë të kemi ambicien për të ecur përpara. Unë nuk mund të marr përsipër të flas para profesoreshës, por Universiteti i Mjekësisë, meqë jam pjesë e institucionit, është një ndër universitetet elitare në Republikën e Shqipërisë.

Po kthehem te shifrat. Sa i takon ciklit shkollor 2019-2020 nuk e kemi rritur tarifën e shkollimit. Nga shteti kemi marrë rimbursim diku në nivelin 60%, por gjatë vitit 2019 janë përfituar nga institucioni ynë 12,7 milionë lekë dhe 28 milionë, bëjnë diku te 40 e ca milionë lekë nga fondet e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në kuadër të thirrjes ku përfituan të gjitha institucionet. Sa janë të mjaftueshme këto? Kjo është një pyetje që kërkon shumë diskutim. Natyrisht nuk janë të mjaftueshme dhe kjo gjë ndikon te pjesa e kërkimit shkencor. Edhe vjet në këtë komision kemi pasur si kërkesë ngritjen e qendrës së stimulimit klinik, e cila me mbështetjen dhe me patronazhin e Ministrisë së Shëndetësisë u krye dhe është në proces.

Në vlera, ajo që u kërkuara nga institucioni, e kam për pjesën e mbulimit të 12 muajve për pagat e gjithë personelit akademik dhe administrativ, bëhet fjalë për një rritje prej 120 milionë. Sa i takon mbështetjes financiare për shtimin e ambienteve të universitetit, konkretisht për Fakultetin e Mjekësisë Dentare është përlogaritur për një shtesë ambientesh 1000 m² me

një vlerë prej 577 800 euro, për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, e cila është ende në fazën e projektimit dhe të studimit, kërkohet një vlerë më e vogël diku te 1 milion lekë të reja, por pas studimit të projektit do të dalë edhe vlera e saktë se sa duhet.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Ju lutem, shumë shkurt, sepse më duhet ta mbyll mbledhjen!

Anila Bullo – Do të flas shumë shkurt vetëm për t’ju dhënë një informacion.

Sigurisht vlera e një universiteti varet shumë se sa tregu i punës e përthith produktin e këtij universiteti dhe realisht jam e lumtur që produkti i Universitetit të Mjekësisë përthithet nga tregu ndërkombëtar.

(Diskutime pa mikrofon)

Jam e lumtur nga pikëpamja akademike, por nuk jam e lumtur nga pikëpamja shëndetësore. Nga pikëpamja akademike më vjen shumë mirë që programet tona studimore njihen dhe vlerësohen nga tregu evropian, por sigurisht nga pikëpamja njerëzore dhe si mjeke, më vjen shumë keq që produkti që japim për pacientët shqiptarë na largohen. Kjo duhet parë me syrin se si mundemi ne të lejojmë që mjekët, që i edukojmë për 10 vjet, nuk duhet të harrojmë që edukimi i një mjeku zgjat minimumi 10 vjet, të na ikin për kurimin e pacientëve evropianë. Nga pikëpamja akademike më vjen mirë që kurrikulat tona vlerësohen shumë nga vendet europiane, gjë, që tregon, pavarësisht rankimit që ju përmendët, se ky universitet në të vërtetë ka vlerë, sepse produkti i tij ka vlerë, sepse në fund të fundit kjo është vlera kryesore dhe testimi për një universitet.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Erion, të lutem, po e kalojmë afatin e parashikuar!

Erion Piciri – Zonjë, ju keni fatin e madh të merrni burimet më të mira njerëzore shqiptare. Europa kërkon burime njerëzore dhe merr burimet tona njerëzore...

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse burimet tona njerëzore do të kishin edhe universitete cilësore, këta do të dilnin më të mirët e kësaj bote, sepse është lloji i racës që është ambicioze.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, Erion!

Të gjitha materialet që keni depozituar pranë shërbimeve të komisionit do të trajtohen nga komisioni dhe do të pasqyrohen në relacionin që do t’i drejtojmë Komisionit përgjegjës të Financave.

Faleminderit!

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

3.Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me rektorët e universiteteve publike të rretheve.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Musa Ulqini, Almira Xhembulla, Fadil Nasufi, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Adelina Rista, Klajdi Qama, Ramazan Gjyzi, Kostaq Papa, dhe Amra Barova.

Mungojnë:

Fidel Ylli, Selami Jenishehri, dhe Enada Kapllani

Të ftuar:

Skënder Topi - rektor i universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,

Enslemvera Zake - administratore në universitetin e Korçës “Fan Noli”,

Roland Zisi - rektor i universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”,

Mirela Duka – administratore e universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”.

Vijon pika e tretë e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje!

Vijojmë me seancën dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020” me rektorët e universiteteve publike të rretheve.

Nga Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”, Roland Zisi, rektor. Mirë se erdhët!

Mirela Duka, administratore.

Universiteti i Korçës “Fan Noli”, Enslemvera Zake, administratore.

Universiteti i Durrësit ende nuk ka përfaqësues.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Skënder Topi, rektor.

Mirë se erdhët!

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Adem Bekteshi, rektor.

Të merret informacion nëse do të paraqitet dikush nga Universiteti i Shkodrës dhe nëse e ka dërguar relacionin me shkrim pranë shërbimeve të komisionit!

Mirë do të ishte të ishin të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e universiteteve publike në rrethe.

Pjesëmarrja për mua është jo e mjaftueshme.

Vijojmë me seancën dëgjimore.

Zoti Roland Zisi, rektor i universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”. Urdhëroni!

Roland Zisi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ju faleminderit për ftesën që na keni dërguar në funksion të shqyrtimit dhe të paraqitjes së kërkesave buxhetore të universitetit “Ismail Qemali”!

Unë jam këtu së bashku me zonjën Mirela Duka, që është administratorja e këtij universiteti dhe besoj se ajo do të diskutojë me detaje lidhur me kërkesat që ka universiteti për vitin akademik 2019-2020, por edhe në vijim.

Ajo që do të shprehja qysh në fillim është se ky është një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm për të diskutuar për nevojat dhe hallet e universitetit tonë.

Unë do t’u referohem vetëm kërkesave të studentëve, edhe ato gjatë vitit të kaluar kur u përfshinë të gjitha organet qeveritare dhe që morën shënim dhe evidentuan të gjitha kërkesat e studentëve dhe të pedagogëve.

Në mënyrë paralele i kemi dërguar këto kërkesa edhe në rrugë zyrtare elektronikisht, sipas porosisë dhe njoftimit që na bëri zoti Bela.

Megjithatë, është e rëndësishme për të theksuar dy probleme:

1. Të mbështetet financiarisht ndërtimi i godinës së Fakultetit të Infermierisë, i cili zhvillon disa programe studimi, kuotat e të cilëve realizohen që në raundin e parë të regjistrimeve. Programet e studimit të infermierisë është e nevojshme të financohen duke u bërë godina, jo vetëm për shkak se është një fakultet i kërkuar në rajon dhe në vend, por ne aktualisht, edhe jashtë fuqive tona financiare, nuk mundemi dot të kemi një proces mësimor brenda godinave që janë në pronësi të institucionit, por me vështirësi të madhe kemi marrë me qira një godinë private, kundrejt procedurës ligjore, por e shikojmë se kjo punë nuk mund të vijojë për shumë kohë, që mësimi të bëhet duke paguar qira.

Ju informoj se universiteti i ka kryer të gjitha detyrimet e veta ligjore, ka prokuruar dhe ka bërë projektin e godinës, e keni sipërfaqen ku do të ndërtohet godina, për shkak se me një vendim qeverie vitin e kaluar, për të cilin dëshiroj të falënderoj sërish qeverinë që na ka dhënë një sipërfaqe goxha të madhe.

Ajo që është e rëndësishme është se edhe bordi i administrimit, edhe senati, edhe rektorati, edhe rektori, prej një viti kërkojnë të mbështet financiarisht kjo godina. Na është premtuar, por ne kemi paralelet dhe 20%-shin që e kërkon ligji dhe nëse do të na jepet edhe një premtim nga ministria, ne mund ta fillonim ndërtimin e kësaj godine.

Pra, kërkesa e parë dhe më imediate e universitetit tonë është mbështetja financiare nga qeveria për ngritjen e godinës së Fakultetit të Infermierisë.

2. Unë desha të dija nëse fondet që neve na ikin nga universiteti për shkak të VKM-ve të reduktimit të tarifave, a do të jenë në këtë buxhet, apo do të jenë të parashikuara më vonë? Njëkohësisht kemi nevojë edhe për laboratorë dhe për mbështetje për laboratorët dhe për kërkimin shkencor.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Fjalën mund ta marrë edhe administratorja për të shprehur më tej nevojat të përkthyer në shifra.

Mirela Duka – Siç u shpreh edhe rektori, kërkesa primare e universitetit të Vlorës, që nuk mund ta mbulojë me fondet e veta, është ngritja e godinës së Fakultetit të Shëndetit Publik. Nuk është vetëm një aspekt infrastrukturor; ky fakultet është mjaft i kërkuar në treg. Shumë nga kuotat që përcaktohen, mbushen qysh në raundin e parë. Përveç tri degëve që i realizojnë kuotat qysh në raundin e parë të regjistrimeve, janë bërë kërkesa edhe për degë të reja që normalisht i kërkon tregu i sotëm kombëtar dhe mbarëkombëtar. Diplomat e Fakultetit të Shëndetit Publik njihen dhe konvertohen edhe në venet e BE-së; është shumë e kërkuar në Gjermani dhe në Zvicër.

Për sa u përket laboratorëve, theksoj se sot nuk kërkohen vetëm laboratorë në aspektin didaktik, por edhe laboratorë profesionalë. Sot Fakulteti i Shëndetit Publik është duke ndërtuar një laborator të mikrobiologjisë, i cili do t'i shërbejë jo vetëm aspektit didaktik të mësimdhënies, por do të përdoret edhe në tregun e gjerë apo për nevojat që ka komuniteti i Vlorës për këtë shërbim.

Një kërkesë tjetër është për sistemin e ngrohjes. Kjo është një kërkesë që ka ardhur nga studentët dhe këshillat studentore që aktualisht janë të konstituara.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Besoj se edhe ju jeni njohur me relacionin për buxhetin 2020, me projektligjin, po ashtu edhe me tabelën e investimeve.

Si mendoni, a i plotëson nevojat tuaja alokimi i buxhetit 2020? A keni nevojë për rritje fondesh?

Unë këtu shoh se keni paraqitur kërkesat tuaja, por nuk keni paraqitur një tabelë të përkthyer në shifrat financiare.

Mirela Duka – Vlera e objektit është 4,2 miliardë lekë. Ky është një projekt, i cili është dorëzuar në Ministrinë e Arsimit me shkresë zyrtare, është dorëzuar edhe projekti i miratuar.

Për sa u përket laboratorëve, ka një kërkesë diku te 60 milionë lekë për laboratorë të fushave të ndryshme, të inxhinierisë, infermierisë, të navigacionit, pra përfshihen disa degë.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Fjalën e merr rektori i universitetit të Elbasanit, zoti Skënder Topi.

Skënder Topi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të komisionit, deputetë, profesorë, administratorë,
Faleminderit për ftesën!

Si çdo vit ne jemi prezentë dhe besoj se nga viti në vit po i përmirësojmë gjërat dhe po i rregullojmë. Parvjet kishim, vjet s'kishim asgjë, ishim në dietë, por këtë vit patëm ca gjëra të mira dhe duhet t'i themi.

Në lidhje me Paktin për Universitetin theksoj se është herë a parë që universitetet shtetërore në Shqipëri u bënë pjesë e një projekti rreth 1 milion e gjysmë euro të akorduar nga qeveria. Pra, ishte hera e parë në këta 5 vjetët e fundit që ky buxhet iu shpërnda universiteteve nëpërmjet projekteve me aplikimet që ne bëjmë.

Universiteti i Elbasanit mori një projekt prej 14 milionë lekësh të reja për një laborator dixhital, për të cilin jemi në proces. Kjo është një gjë shumë pozitive.

Duke parë projektbuxhetin krijova idenë se janë shumë gjëra të shkruara në letër, që janë të shkruara mirë. Pyetja është se sa jemi ne në gjendje t'i realizojmë ato.

Në një pikë thuhej se numri i studentëve për metër katror duhet të jetë një student në 5-8 metra. Sot në universitet shtetërore shqiptare kjo është e përealizueshme në raport me numrin e kuotave që kemi, por është tepër pozitive dhe e domosdoshme.

Një gjë tjetër ishte akreditimi i gjithë programeve të universiteteve shtetërore deri në vitin 2030.

Të gjitha universitetet shtetërore, ndoshta edhe ato private, kanë kaluar një fazë të procesit të akreditimit institucional me një agjenci britanike, që na ka bërë shumë mirë. Jemi në proces pune me komisionet dhe Universiteti i Elbasanit, brenda muajit maj bën edhe akreditimin e dytë institucional me nivel universiteti.

Akreditimin e parë që kishim e morën për tre vjet. Është e çuditshme, por një ndër mangësitë që kishte Universiteti i Elbasanit ishte mungesa e shkallëve anti-inçendio.

Dua t'u tërheq vëmendjen anëtarëve të komisionit, se për mungesën e shkallëve anti-inçendio nga 6 vjet, kemi rehabilitimin në 3 vjet. Kjo është një gjë e dokumentuar, por shpresojmë që në procesin e dytë të marrim maksimumin sepse i plotësojmë të gjitha kushtet dhe kriteret që kërkon ligji.

Pash një element tjetër në projektligj, ku thuhej se duhen 15 studentë për një staf akademik të brendshëm. Bëra një llogari të vogël: Universiteti i Elbasanit ka 12-13 mijë studentë. A do të jetë e realizueshme kjo gjë (bëhet fjalë për vitet 2022-2030)?

Do të ishte shumë pozitive, por nuk e di sa do të jetë e mundshme të realizohet.

Si një nga prioritetet e qeverisë, qysh prej dy vjetësh, ne kemi bërë pjesë kurrikulat profesionale dyvjeçare. Sot në universitetin tonë kemi rreth 900 studentë, të cilët bëjnë pjesë në këto kurrikula dyvjeçare.

Dua të tërheq vëmendjen e komisionit, se për studentët që marrin një diplomë dyvjeçare shteti nuk e ka për detyrë, apo ne, që t'i punësojmë, por si për çdo kurrikul tjetër është domosdoshme që edhe degët profesionale të kenë një bazë ligjore të paraprirë që të kenë edhe një hapësirë në shtet (mund të jenë asistentë, und të jenë ndihmës në shkolla të mesme apo 9-vjeçare). Sot nuk ka një bazë ligjore.

Në qoftë se duhet t'i forcojmë këto degët dyvjeçare profesionale, që janë të domosdoshme, ka nevojë që t'i paraprijmë me një bazë ligjore.

Elementi tjetër i rëndësishëm është se në gjithë këto vjet kemi pasur investime pothuajse zero. Universiteti i Elbasanit ka pasur investime pothuajse zero në infrastrukturë.

Me sa kemi informacion nga Ministria e Arsimit edhe për këtë vit për kërkimin shkencor ishin rreth 6 milionë lekë. Kjo është një gjë shumë pozitive, se universitetet shtetërore mund të aplikojnë për projekte, për laboratorë që janë të domosdosëshëm në institucionet tona, në qoftë se duam kërkim shkencor, e kam thënë dhe po e përsëris, se shkencë pa para nuk ka. Këto para, për këto projekte, me të cilat krijuam laboratorë dhe jemi në proces tenderimi, do të ishte pozitive që për vitin tjetër të dyfishoheshin, që ne të zbusim pak dhimbjen në institucionet tona.

Prioriteti i Universitetit të Elbasanit nuk ka qenë buxheti i shtetit, por ndërkombëtarizimi i universitetit. Ne sot kemi për këtë vit dhe për vitin që vjen rreth 220 projekte Erasmus, që kanë të bëjnë me mobilitetin e stafit dhe të studentëve tanë të cilët shkojnë në Europë dhe të tjerë studentë nga këto vende vijnë në universitetin tonë.

U kemi dhënë prioritet studentëve duke bërë 6-mujor Erasmus me 850 euro në muaj (të gjitha projekte të komunitetit europian) dhe kjo ka qenë shumë pozitive.

Kemi punuar fort dhe kemi rreth 5 projekte *capacity building* që kemi bërë me universitetet europiane, ku jemi partnerë dhe ndiehem liderë dhe kjo na ka ndihmuar shumë se sot në Universitetin e Elbasanit, vetëm me projekte, pa buxhetin e shtetit, kemi krijuar 5 laboratorë të rëndësishëm, si në shkencat e edukimit për trajnimin e mësuesve, te biblioteka e universitetit, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, kemi një laborator dixhital në Fakultetin e Ekonomisë, si dhe jemi në proces për të krijuar në projekt tjetër me Universitetin e Firences, të cilin e kemi fituar dhe jemi partnerë (me pak para, nga 60-100 mijë euro është pjesa jonë, përveç mobiliteteve, hulumtimit, botimeve është pjesa teknike, laboratorët që kemi krijuar).

Shteti gjithmonë duhet të hedhë një sy, sepse po të shikoni (nuk kam asnjë me universitetet private, respekt maksimal) pavarësia jonë në raport me bërjen e gjërave në universitet është tepër-tepër e komplikuar.

Po ju jap një shembull. Kemi 3 muaj që kemi shpallur një tender për kartonët e diplomave të studentëve. Janë disa firma dhe çdo 2 javë ankohet njëra dhe ndeshemi në portalin e Kryeministrit, që studenti mbaron studimet dhe duhet të presë 6 muaj apo një vit për të marrë një karton. Zallamahia vazhdon edhe më tej, se degët e mësuesisë dhe Infermierisë dhe kështu me radhë. Shkojnë dhe bëjnë provimin atje me vërtetim dhe listën e notave. Është një problem tepër i madh dhe studentët nuk pranohen, sepse kërkohet kartoni i diplomës. Ka pakënaqësi nga të gjitha pikëpamjet. Nuk e di nëse ky komision e ka apo jo tagrin, pasi ka disa gjëra të rëndësishme në universitet dhe duhet të gjendet mekanizmi për t'i zgjidhur. Ministria duhet të gjejë një mënyrë që të mos kemi probleme me kartonët, minimumi i domosdoshëm për studentët. Të bëhet një pakt me kontratë afatgjatë dhe kështu me radhë, siç e bën e gjithë bota. Rrimë nga 1-2 vjet për të marrë një karton. Ky është një problem shumë i madh.

Që të mos zgjatëm më tej për investimin në universitet. Ka rreth 6 vjet, pa u bërë unë rektor që Universiteti i Elbasanit ka bërë një projekt, kemi godinën e ish- kirurgjisë së vjetër për ndërtimin e Fakultetit të Shkencave Humane. Kemi 2 fakultete prej 30 vjetësh që janë në një godinë, në kampusin qendror të universitetit. Prej 2 vjet e gjysmë, kur ishte zonja Nikolla ministre, e cila është në dijeni, kemi të sjellë të gjithë projektin, me të gjitha sugjerimet e bëra nga ekspertët e Ministrisë së Financave dhe asaj të Arsimit. Kemi mbyllur për 2 vjet e gjysmë 1 miliardë e 400 milionë lekë, paratë e studentëve, me kursimet që kemi bërë. Janë të mbyllura në thesar, sepse rregulli e kërkon 20%-shin e këtij investimi 5-6 milionë euro, por do t'jua dërgojmë me *e-mail* që të keni edhe detajet teknike dhe administrative. Ende sot jemi në këtë fazë. Ky është një motiv më shumë, se edhe në projektligj shkruhet që numri për metër katror për studentë të jetë 5-8 metra. Kjo rregullon shumë balanca në universitetin tonë. Nuk i

kërkojmë sot e nesër këto para, por mund të shtrihen në 2-4 vjet, të fillojmë procesin, të ndihmojmë edhe ne, edhe shteti.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm është se Universiteti i Elbasanit ka një specifikë shumë të madhe, ka rimbursimin më të madh të shtresave në nevojë, në bursa e kështu me radhë, duke u mbështetur në VKM-të e vitit të kaluar.

Pyetja ime, e bëri edhe profesor Landi, ne jemi në proces, sepse respektojmë VKM-të, rimbursimi i këtyre shtresave që për ne është 80-90% e të ardhurave tona, do të jetë në buxhet apo në aktin normativ? Nëse është në buxhet, në janar-shkurt mund ta bëjmë buxhetin, por nëse nuk është në buxhet, atëherë duhet të presim një akt normativ dhe nuk bëjmë dot buxhet. Të gjithë e dini se qeveria sjell 8-9 muaj rrogat, sigurime shoqërore dhe pjesën tjetër ne e bëjmë nga të ardhurat. Vjet na është bërë në kohë rekord, duhet afalënderojmë qeverinë për këtë gjë, rreth 2 miliardë e ca lekë bëmë buxhetin dhe jemi këtu ku jemi sot. Kjo pyetje është shumë e rëndësishme, e kam nga strukturat administrative, nga administratorët dhe drejtori i Financës: do të jetë në buxhet rimbursimi? Është shumë i madh për ne apo do të jetë me një akt normativ dhe mund të zgjasë në mars, në prill, në korrik e kështu me radhë?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Ju falënderoj profesor për prezantimin e disa prej kërkesave të Universitetit të Elbasanit!

Ju adresuat disa pyetje, që në fakt e meritojnë një përgjigje. Kemi kërkuar sot prezencën edhe të ekspertëve të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Arsimit, besoj se janë njoftuar nga sekretaria e komisionit? Po. Përse nuk janë të pranishëm?

Në fakt, ata duhet të ishin të pranishëm për t'u dhënë përgjigje profesorëve të nderuar lidhur me pyetjet që adresojnë. Ne sërish mund t'i mbledhim, t'i grumbullojmë këtu, por kur nuk marrin dot një përgjigje, atëherë kjo punë do të vazhdojë vit pas viti kështu! Nëse këto kërkesa nuk pasqyrohen në buxhet, si do të veprojmë? Do të zhvillojmë vetëm dëgjesa për të kaluar radhën?

Skënder Topi - Zonja kryetare, a mund t'ju sqaroj!

Këto që thashë unë do t'i dërgoj edhe me *e-mail*, janë të gjitha të dokumentuara në buxhetin që i kemi dërguar Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Financave. Janë të detajuara me zëra, të dokumentuara zyrtarisht.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit profesor!

Relacionin dhe kërkesat tuaja t'i depozitoni pranë sekretarisë së komisionit.

Milva Ekonomi - Për ta sjellë në vëmendje të komisionit. Ju e dini se kur hartohet buxheti, procedura e fillimit të hartimit të buxhetit starton në muajin gusht dhe të gjitha entet

që konsumojnë paratë e buxhetit fillojnë dhe punojnë për këtë qëllim, duke nisur nga hierarkia më e lartë dhe zbret poshtë deri në institucionet kapilare, që ka një institucion i caktuar. Midis Ministrisë së Financave dhe enteve përkatëse bëhet gjithmonë një negociim, ka një datë negociimi. Ti thua: “Unë dua kaq para”, Ministria e Financave thotë: “Unë do të të jap kaq para”. Ti kërkon projekte, ajo thotë: “Do të të jap më shumë”. Ti kërkon edhe më shumë, ajo thotë: “Kaq shumë nuk do të të jap, por aq sa të kam thënë në fillim.”. Gjithmonë ka një negociatë. Po kjo negociatë që zbret si praktikë nga Ministria e Financave, bëhet edhe midis institucionit qendror dhe degëve të tyre. Ma merr mendja që edhe Ministria e Arsimit ka bërë një negociatë me universitetet në momentin e hartimit të buxhetit. Këtu, universitetet vijnë me një kërkesë, me atë projektpropozim që ia kanë dërguar Ministrisë së Arsimit. Ne, si komision, marrim detyrën që për kërkesën tuaj, nëse nuk është plotësuar, t’i bëjmë edhe një herë presion pozitiv Ministrisë së Arsimit, për ta marrë në konsideratë. Ky presion bëhet së bashku me Ministrinë e Financave. Ne hyjmë për të bërë presion në këtë rast te Ministria e Financave. Ky është roli që marrim ne, si komision. Kjo ishte për ta kujtuar për të gjithë ne.

Skënder Topi - Faleminderit!

Gjithçka që thashë është e dokumentuar në projektbuxhetin që kemi dërguar, që bëhet për 2-3 vjet. Shikoni se çfarë ndodh që të jeni të qartë, zotërinj deputetë. Nga momenti që dërgohet buxheti, nuk ka asnjë kontakt me Ministrinë e Financave dhe me strukturat tona. Ne bëjmë një parashikim, por na vjen buxheti i definuar. Kjo ka ndodhur vjet, parvjet, unë kam 3 vjet rektor. Jemi para një dileme shumë të madhe. Jua them sinqerisht. Nuk e di se sa do të presim ende, në akord me administratorin dhe me strukturën financiare, sepse nuk mund të lëmë të bllokuar në thesar 1 miliard e 400 milionë lekë. Janë dy vjet e gjysmë që rrinë të bllokuara për të pritur një financim nga shteti. Nëse ky nuk do të vijë edhe këtë vit, ne jemi të detyruar që ato para t’i investojmë në para për studentët, për laboratorë, për gjëra që i kemi emergjente, sepse nuk mund të shkohet pa fund në këtë drejtim: një, dy apo tre vjet. Prandaj insistoј fort te ky investim që kërkojmë, nuk e diskutoј se shteti ka probleme, me paranë, probleme të natyrave të ndryshme, por kërkojmë një gjë që është domosdoshmëri. Të na jepet një përgjigje dhe të mos presim janarin apo shkurtin dhe të mbetemi në situatën e vitit të kaluar. Gjithçka që thashë është e dokumentuar në buxhetin tonë dhe e ka Ministria e Financave.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit, profesor!

Të dëgjojmë përfaqësuesen e Universitetit të Korçës.

Enslemvera Zake – Faleminderit!

Unë nuk do të shtoja asgjë në aspektin akademik në të gjitha ato që tha edhe profesori i nderuar i Universitetit të Elbasanit lidhur me kapacitetet pritëse, me kuotat në raportin e stafit akademik me studentët, por do të ndalem specifikisht në aspektin financiar.

Së pari, na lind nevoja në buxhetin e shtetit për rimbursimin 100% të efekteve financiare që lidhen me 2 VKM-të e nxjerra në janar për studentët që përfitojnë nga përjashtimi i tarifave apo nga përfitimi i bursave. Ky efekt financiar është në vlerën 64 milionë e 800 mijë lekë për bursat dhe 45 milionë lekë për tarifën.

Një kërkesë e dytë, e cila është specifike jo vetëm për Universitetin e Korçës, është rritja e fondeve të parashikuara për kërkimin shkencor të universiteteve. Specifikisht për Universitetin e Korçës ne kemi kërkuar në projektbuxhet, i cili është i pasqyruar në projektbuxhetin e depozituar pranë Ministrisë së Arsimit brenda afateve ligjore vlerën 5 milionë lekë.

Së treti, ne kërkojmë që të planifikohet në buxhetin e fondeve për përmirësimin e infrastrukturës së laboratorëve, financimin e ngritjes së laboratorëve të rinj në universitet vlerën 30 milionë e 420 mijë lekë, pasi kemi Fakultetin e Bujqësisë që ka një bazë eksperimentale didaktike dhe ka nevojë për laboratorë të rinj, ku një pjesë të të cilave i kemi financuar nëpërmjet projekteve që kemi finalizuar me donatorë të huaj, si me programet “Erasmus plus”, si edhe Departamenti i Biologji- Kimisë ku kërkojmë financimin e laboratorëve të rinj.

Në përfundim, më lejoni të kthej vëmendjen tuaj në një aspekt tjetër të rëndësishëm për Universitetin e Korçës, atë të akreditimit që do të bëhet në vitin 2021. Për këtë çështje është e nevojshme financimi i rikonstruksionit të godinës së Fakultetit Ekonomik, pasi në kushtet aktuale nuk garanton asnjë nga standardet e akreditimit. Ajo është një godinë që ka qenë dikur “Shtëpia e foshnjës” dhe në vitet 1980 është përshtatur për Institutin Bujqësor. Është bërë një rikonstruksion pjesor në vitin 2001 dhe për momentin është aktualisht jashtë standardeve të akreditimit.

E njëjta gjë vlen edhe për Departamentin e Infermierisë, financimi i një godine të re, pasi siç dihet kërkesat për infermierë të përgjithshëm janë shumë të larta dhe ne nuk plotësojmë kuotat dhe kapacitetet pritëse për këtë departament.

Ju bëj me dije se projekti për rikonstruksionin e godinës së Fakultetit Ekonomik shkon në vlerën 62 milionë lekë të rinj, nuk është ndonjë vlerë e konsiderueshme, projekti është gati dhe është përcjellë në Ministrinë e Arsimit, te sekretari i Përgjithshëm së bashku me projektet pasuese siç janë: projekti arkitektonik, ai kundër zjarrit, ai i teknologjisë, si dhe projektet e tjera.

Të gjitha kërkesat tona institucionale i kemi dërguar me shkresë pranë Ministrisë së Arsimit në përputhje me standardin e hartuar nga Ministria e Arsimit për miratimin e projektit buxhetor 2020-2022.

Këto ishin të gjitha kërkesat në vija të përgjithshme. Komisionit, zotit Bela i është përcjellë tani me *e-mail*, i gjithë informacioni bashkë me vlerat financiare.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit për prezantimin e disa prej kërkesave tuaja!

Edhe për ju vlen të theksojmë se relacionin dhe kërkesat duhet t'i paraqisni me shkrim pranë sekretarisë së komisionit.

Ka pyetje nga anëtarët e komisionit?

Po, zonja Nikolla.

Lindita Nikolla – Duke i falënderuar profesorët dhe administratorët për prezantimin, do të doja t'ju garantoja se patjetër ne me shumë seriozitet do t'i trajtojmë të gjitha kërkesat tuaja për t'ia paraqitur komisionit përkatës për Ekonominë dhe Financat, por e theksoj se është shumë e rëndësishme që në relacionin që do të dërgoni, përpikuni t'i rendisni kërkesat në rendin prioritar. Të gjitha këto që përmendët, vetëm Universiteti i Korçës shkon te 226 milionë, unë i mbajta shënim, por ndoshta shifra është edhe me shumë. Mendoni se janë të gjitha universitetet dhe e kemi shumë të vështirë për të ndërtuar një mbrojtje serioze dhe konform mundësive. Duhet të dimë dhe mundësitë. Në atë relacion që do të dërgoni, paraqitni kërkesat tuaja në një rend prioritar.

Për sa i përket pyetjes që bëtë, ne do të marrim të gjithë informacionin nga Ministria e Arsimit, por pavarësisht kësaj, besoj se i kemi pak hapësirat për të rikuperuar dhe nuk besoj se do të jetë një pengesë e madhe, nëse lëvrohet në janar apo në shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I kemi hapësirat, jemi më mirë sesa kemi qenë më parë, sepse qeveria do të mbajë VKM-në e saj për rimbursimin. Pra, me qetësi t'i trajtojmë të gjitha situatat, por na duhet patjetër që në projektet investuese ju të keni një mbështetje më të madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Për universitetet, e kam në përgjithësi, keni një fat të madh që te pjesa e këtij projektbuxheti, komisioni ka caktuar si relatore zonjën Nikolla.

Ta ndajmë këtë gjë: do të kemi një relacion ku të gjitha nevojat do të jenë të argumentuara mirë.

Fatjona Dhimitri – Po, zonja Zake.

Enslemvera Zake - Lidhur me shqetësimin që kishte edhe rektori i Elbasanit për rimbursimin, pasi VKM-ja përcakton saktësisht të gjithë studentët që e përfitojnë apo

aplikojnë për bursë që nga muaji tetor, ata duhet ta marrin nga muaji nëntor dhe në vazhdim, nëse projektbuxheti miratohet në muajin mars të gjitha universitetet do të jenë përballë faktit se për periudhën tetor- nëntor- dhjetor nuk do të kenë aftësi për t'i paguar në kohë. Është diçka sensitive lidhur me studentët, pasi ata do të pretendojnë që VKM-ja është miratuar, por ne nuk i kemi marrë bursat, sepse ne i përfitojmë që në muajt tetor-nëntor-dhjetor, por edhe në shkurt ne nuk i kemi marrë, pavarësisht se do t'i marrim të gjitha të përmbledhura, por është diçka sensitive, duke pasur parasysh edhe situatën e dhjetorit të vitit të kaluar.

Fatjona Dhimitri - Keni diçka për të shtuar, profesorët e Vlorës dhe të Elbasanit?

Skënder Topi - Duke qenë se relatore është ish-ministrja që ka ndarë shumë halle me ne, është një faktor më shumë, se i njeh më shumë problemet tona. Ne nuk pretendojmë t'i zgjidhim problemet tona sot apo nesër. Zonja ministre u mor me Korçën, nuk u mor me Elbasanin, sepse e ka kaluar vetë këtë situatë dhe kemi kaq vite që lodhemi, kërkojmë jo lëmoshë, por një minimum që qeveria, Ministria e Financave t'i hedhin sytë nga universitetet shtetërore, sepse prioritetet duhet të kenë universitetet shtetërore, pa u hequr asgjë privatëve, sepse secili ka të drejtën e tij. Nëse ne kërkojmë akreditim, cilësi, atëherë cilësi pa para nuk ka. Ne mundohemi të bëjmë maksimumin, por kërkojmë ndihmën e qeverisë brenda të gjithë kufijve ligjorë.

Roland Zisi - Për kursimet dhe mungesën e parave, universiteti "Ismail Qemali" heq dorë nga laboratorët e të tjerë dhe kërkon vetëm mbështetjen financiare për godinën e Infermierisë. Nuk kërkojmë asgjë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është prioriteti që të kemi 20%-shin tonë, të kemi projektin, e kemi financuar vetë, e kemi bërë, e kemi edhe vendin, i kemi dhe studentët.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Ne i kemi pak a shumë relacionet tuaja. Uroj që kërkesat tuaja të merren parasysh në buxhetin e shtetit. Shpresoj që të mos jeni më me qejf të mbetur për sa u përket problematikave që hasin universitetet tuaja në pasqyrimet në buxhet.

Do të kemi sërish dëgjesa të tjera.

Ju falënderoj për prezencën tuaj!

Do të ishte mirë të kishim të pranishëm edhe përfaqësuesit e universiteteve të Gjirokastrës dhe të Durrësit. Nuk e di se si do t'ia bëjmë. Nëse janë rrugës, duke ardhur, që të kishim mundësi t'i dëgjonim.

Mbyllet pika e tretë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

4. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Musa Ulqini, Almira Xhembulla, Fadil Nasufi, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Adelina Rista, Klajdi Qama, Ramazan Gjyzi, Kostaq Papa, dhe Amra Barova.

Mungojnë:

Fidel Ylli, Selami Jenishehri, dhe Enada Kapllani.

Të ftuar:

Ardit Bido - drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave,

Arben Dervishi - Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse,

Endrit Musaj - Drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve,

Lorisa Kushi – përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (MFE).

Vijon pika e katërt e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri - Viojmë seancën dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Të ftuar kemi: zotin Ardit Bido, drejtor i Përgjithshëm i Arkivave, zotin Arben Dervishi, drejtor i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse dhe zotin Endrit Musai, drejtori i Inspektimit dhe i Trajnimeve.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Cilat janë kërkesat tuaja lidhur me parashikimet e buxhetit të vitit 2020? Si e mendoni ju, ky alokim fondesh a i mbulon nevojat e institucionit tuaj apo keni nevojë për fonde shtesë? Cilat janë ato?

Ardit Bido - Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka një çështje, e cila besoj është thelbësore për të hyrë drejtpërdrejt në temën për të cilën na keni ftuar, e cila ka të bëjë me investimin më të madh që është bërë ndonjëherë në arkivat e shtetit, që ka të bëjë me ndërtimin e godinës së vendruajtjes arkivore. Ky projekt është miratuar nga ky komision e më pas nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave për PBA-në 2018-2020, në vleftën prej 280 milionë lekë. Në çastin që ajo kaloi për miratim, për të ndryshuar buxhetin në Ministrinë e Financave, u vendos që në PBA-në 2018-2020 të përcaktohej një shifër prej 200 milionë lekësh, e mjaftueshme për të ndërtuar godinën, e cila tashmë është gati me të gjitha parametrat arkivore. Në një moment të dytë, pasi të mbaronte kjo PBA, pra ndarja në 40 milionë, 80 milionë e PBA-së 2018-2020, u vendos që të vijohej me financimin tjetër, sa u përket raftëve të kësaj godine të re, raftë arkivore, të cilat do ta mbyllnin njëherë e mirë gjithë gangrenën që kanë arkivat.

Në këtë pikë dua të theksoj se ndërtimi i vendruajtjes arkivore nuk është çështje luksi. Ishim dhe jemi në momentin kur nuk ka më hapësira për të ruajtur dokumentacionin që prodhojnë institucionet shtetërore. Për ta thënë ndryshe, ekziston rreziku i mundshëm, që më shumë të mund të dimë se çfarë ka ndodhur në vitet ‘30 sesa çfarë ka ndodhur në vitet 2000, e madje pas ca vitesh, ato që kanë ndodhur në vitet 2000 t’i marrim nga mediet, jo nga dokumentet burimore arkivore. Prandaj, kjo ka qenë thelbësore.

Së dyti, ka qenë thelbësore për shkak të mungesës së kushteve teknike dhe kostove që kjo gjë prodhonte. Dokumentacioni i dëmtuar prodhon kosto shumë herë më të larta, sepse duhet të kalojë në fazën e restaurimit, gjithnjë nëse mund të jetë i restaurueshëm, se pastaj, pas disa procesesh restaurimi, ai kthehet në diçka të parestaurueshme.

Në këtë pikë ku ndodhemi, ne kemi problematikën e mungesës së financimit të 80 milionë lekëve për mbylljen e kësaj godine. Jua thashë edhe pak më parë: kjo gjë na pengon, sepse nuk mbledhim më dokumentacion. Përtej kësaj, i bie që godina e sapondërtuar të amortizohet. I bie të jetë bërë investim më kot, sepse nuk mund të kthehet në diçka funksionale.

Mbase problematika mund t'ju duket pakëz e tepruar, por kërkesa jonë është që ky 80-milionësh të vendoset në tavanin nr. 11, që është mbi buxhetin 2021, por e kemi të domosdoshme që të vendoset sivjet, sepse një pjesë të fondit e kemi të liruar në 2020-ën, e kështu mundësojmë nisjen e procedurës që në vitin 2020, për ta përmbyllur brenda 2020-ës, pavarësisht se një pjesë e shumës do të paguhet në 2021-shin. Përndryshe, edhe me atë pjesë të fondit që e kemi në 2020-ën, nuk kemi çfarë të bëjmë praktikisht, ose do të shkojë në projekte, të cilat nuk janë prioritare. Praktikisht, nuk do të ketë rezultatin e nevojshëm.

Kjo është problematika më e madhe, të cilën shpresojmë ta merrni në konsideratë, sepse është bërë një investim dhe i bie që ky investim të jetë bërë më kot, për shkak të mungesës së gjithë ciklit të vet.

Pa dyshim, ka edhe problematika të tjera. Për ta kapsuluar për komisionin, nëse ne do të shohim tavanet buxhetore, vetëm tek investimet janë planifikuar afro 300 milionë lekë për arkiva të ndryshme të sistemit, ndërsa buxheti vjetor i investimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave është 5 milionë lekë. Pra, përtej kësaj, përtej një shpenzimi *ad hoc*, që ndodh vetëm sa i përket godinës në Shkozë. Për ta kuptuar diferencën mes 300 milionë lekëve, që u jepet arkivave të sistemit, dhe 5 milionë lekëve që i jepen Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ruan sa të gjithë arkivat e sistemit të marra së bashku, shumëzim për dy. Megjithatë, merr 5 milionë investim, ndërkohë që të gjithë arkivat e tjerë të sistemit marrin 300 milionë lekë.

Nuk e di nëse është e dukshme ashtu si për ne kjo lloj disbalancë mes 24 kilometrave linearë dokumentacion, që ruajmë ne, dhe arkivave që ruajnë maksimumi 2-3 kilometra linearë, por që marrin diku te 60 herë më shumë në projekte investimi, se sa Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Po ashtu, besoj sikurse është vënë re tek të gjitha institucionet, gjë që është problematike edhe për ne, ka një tkurrje të shpenzimeve operative përgjatë këtij viti. E mirëkuptojmë se është një tkurrje që duhet të ndodhë, siç ndodh tek të gjithë, por kjo na krijon vështirësi. Gjithsesi, derisa është vullneti i tillë, nuk kam çfarë të them më tej, është një vështirësi që do ta përballojmë, sepse një pjesë të mirë të buxhetit tonë e çojmë në disa gjëra që nuk kanë qenë deri para ca kohësh.

Ne shpenzojmë një të tretën e buxhetit për dixhitalizim dhe sot kemi sisteme elektronike që janë të lakmueshme nga vendet e rajonit, e jo më nga institucionet e tjera analoge në Shqipëri, shpenzime që nuk bëheshin deri para një viti e saj. Pra, ne e kemi bërë vetë tkurrjen. Shpenzimet normale operative i kemi tkurrur në maksimum, për shkak se kemi dashur

t'i japim hov një procesi të ri. Një tkurrje e mëtejshme na vendos në një pozicion shumë të vështirë. Nuk kam çfarë të them, por do të përpiqemi ta përballojmë si të mundemi për këtë vit.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Dëshiron ta marrë fjalën ndokush nga të ftuarit e tjerë, përfaqësues të arkivit?

Faleminderit!

Zoti Bido, ne e kemi edhe shkresën tuaj drejtuar komisionit tonë. Pak a shumë, është një shkresë me më shumë fjalë e më pak shifra, por në fakt, të gjitha ato që ju referuat, do të donim të na i përkthenit në një tabelë investimesh në lidhje me atë që është realizuar në 2019-ën, si dhe çfarë kërkonit ju që të realizohet me buxhetin e 2020-ës, në mënyrë që edhe gjatë hartimit të relacionit tonë drejtuar komisionit përgjegjës, të kemi parasysh se ku kanë shkuar fondet që i janë alokuar Arkivit Qendror të Shtetit. Kështu që, në shkresën tuaj duhej të ishte pasqyruar edhe një tabelë e tillë.

Në lidhje me pyetjet që ju mund të keni për Ministrinë e Financave, besoj se e kemi përfaqësuesen e ministrisë. Mund t'i drejtoni pyetjet, nëse keni pyetje konkrete.

Meqenëse zonja është e pranishme, besoj se duhet të ketë diçka për të referuar, qoftë edhe në lidhje me pyetjen që ju drejtova unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë do të duhej të ishte edhe personi përgjegjës, meqenëse në dëgjese kemi edhe Arkivin Qendror.

Kështu, zoti Bido, unë e kam shkresën, sikundër e thashë, i kam të gjitha kërkesat tuaja. Relacionin tjetër që do të sillni, pasi jua parashtrova unë si kërkesë, do t'ia drejtoni shërbimeve të komisionit. Së bashku me anëtarët e tjerë të komisionit, ne do ta trajtojmë gjatë hartimit të relacionit përfundimtar, për t'ia drejtuar më tej komisionit përgjegjës.

Po, urdhëroni, zonja Nikolla!

Lindita Nikolla – Do të flas në cilësinë e relatores. Në fakt, drejtori e ka paraqitur saktë kërkesën e tij. Si rend prioritar kanë emergjencën për investimin e një fondi prej 80 milionë lekësh, sepse është bërë investimi i godinës. Tashmë, që të futet në funksion, duhet të pajiset edhe me mjete. Pra, kjo është.

Fatjona Dhimitri – Ajo që mbetet e paqartë, të paktën po jua drejtoj unë këtë pyetje, është: ku kanë shkuar të gjitha lekët që i janë alokuar Arkivit të Shtetit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po pra. Pikërisht, pse jo? Pse të mos u kërkojmë llogari? Po kërkon ti llogari për pyetjet e tua. Pse të mos marr edhe unë përgjigje për pyetjet e mia?

Ardit Bido – Faleminderit për pyetjen, zonja Dhimitri. Vërejtjen e marrim në konsideratë. Nëse komisioni e gjykon të arsyeshme, do ta sjellim tabelën. Tabela është e thjeshtë. 80 milionë për tabelën 11, që i bashkëlidhet buxhetit. Kjo ka qenë arsyeja se përse nuk e kemi sjellë, sepse është një kërkesë shumë konkrete për një shtesë të fondit.

Sa i përket pyetjes suaj, u përpoqa ta shpjegoja pak më parë, që në fund të vitit 2017, kur po përgatitej projektligji i buxhetit të vitit 2015, përfshi PBA 2018-2020, ky komision i nderuar dhe Komisioni i Financave kanë miratuar 280 milionë lekë për një projekt që ne kemi sjellë. Nga këto, 280 milionë lekë, kur u reflektua në vitin 2017 ky propozim i Komisionit të Edukimit dhe Komisionit të Financave, nga Ministria e Financave, u vendos, dhe ashtu kaloi edhe në ligjin përfundimtar, që do të ishin në PBA 40 milionë, 80 milionë, 80 milionë. Në total, për tre vite 200 milionë. Në këtë kuptim, ato 200 milionë, me logjikën dhe arsyetimin që të ndërtohej njëherë godina, e më pas të vijohej me pjesën e brendisë së godinës. Këto 200 milionë lekë që janë alokuar, janë kthyer në një ndërtesë, e cila në çastin që do të mobilohet dhe do të mund ta prezantojmë, pasi tashti i bie të prezantojmë vetëm karabinanë, do të jetë jo thjesht godina e vetme arkivore me standarde në Shqipëri, por dhe një godinë që s'ia ka zili asnjë godine tjetër arkivore. Për sa i përket ndërtesës arkivore, ajo ka standardet më të mira ndërkombëtare. Duhet ta kuptojmë se ndërtesat arkivore kanë kosto më të lartë. Shembujt janë të pafundmë, por po marr një shembull: kati i dytë duhet të ketë një normë mbajtjeje prej 700 kilogramësh për metër katror. Pra, praktikisht është si bunker. Nuk është ndërtesë e zakonshme, sepse për shkak të peshës së madhe që kanë dokumentet kur vendosen njëra mbi tjetrën, godina duhet të ketë kapacitet të madh peshëmbajtës.

Kësisoj, ky 200-milionësh është shpenzuar për ndërtimin e godinës. Tashmë është duke u kërkuar 80-milionëshi që ka qenë i miratuar nga ky komision, si dhe nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave. Kaq, sa i përket kësaj pjese.

Sa i përket fondit të zakonshëm prej 5 milionë lekësh, që ka Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, që është tmerrësisht shumë pak, gjë që ka ardhur për shkak të mbetjes në tabela, që në një moment të caktuar është bërë një ndërprerje, duke shkuar nga 30 milionë në 5 milionë. Pastaj tabelat vështirë se ndërrohen, kur bëhet buxheti, se nganjëherë marrin një inerci të caktuar, gjë për të cilën besoj se ndani të njëjtin mendim me mua.

Me këtë 5-milionësh kemi bërë cirk, në kuptimin që, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka 18 godina në të gjithë Shqipërinë dhe vetëm hidroizolimet që duhen bërë kur vjen momenti, shkojnë nganjëherë mbi 5 milionë. Kësisoj, janë parë njëmijë e një forma, për të gjetur mundësinë të mbushim diferencën mes 5-milionëshit që na ofron buxheti i shtetit dhe asaj që realisht duhet për minimumin e minimumit.

Cilat janë këto forma? Janë donacionet e huaja që ne kemi tërhequr, janë bashkëpunimet e brendshme që ne kemi bërë me institucione të tjera private e shtetërore, që të mund të arrinim minimumin.

Kjo është përgjigja, sa i përket 200-milionëshit tashmë të alokuar. Godina është në Shkozë, është ekzistente. Ka nevojë për mobilie, përndryshe nuk prezantohet dot. Sa i takon kërkesës tuaj, patjetër që do t'ju sjellim tabelën numër 11 për grupin 20, që është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Fatjona Dhimitri – Me të gjithë zërat e shpenzimeve.

Ardit Bido – Është shumë e thjeshtë, sepse kemi vetëm një veprimtari, nuk është se kemi disa veprimtari, prandaj ka qenë një neglizhencë nga ana jonë për të sjellë tabelën, gjë për të cilën ju kërkojmë ndjesë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit për pjesëmarrjen, zoti Bido!

Ashtu sikundër e thashë, shkresën që kemi prezente, kërkesat që paraqitët gjatë mbledhjes në komision e po ashtu edhe materiali shtesë që unë kërkoja të depozitohet pranë komisionit tonë, do të trajtohen nga anëtarët e komisionit në momentin e hartimit të relacionit përfundimtar, për t'iu dërguar më pas Komisionit të Ekonomisë.

Ju falënderoj për prezencën tuaj.

Mbyllim seancën dëgjimore me Arkivin e Shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, praktika e deritanishme...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, ne nuk kemi asnjë emergjencë. Ne respektojmë komplet rregulloren dhe kalendarin e Kuvendit, ku ju keni qenë ulur dhe keni marrë vendim si kryetare e komisionit. Tani, buxheti është gjithmonë një akt i gjatë diskutimesh, nuk bëhet dot shpejt dhe ndahet në disa momente. Momenti i parë është miratimi në parim, pasi dëgjohen të gjitha institucionet e varësisë, siç po i dëgjojmë tani. Momenti i dytë është kur dëgjohen të gjitha grupet e interesit, sindikatat, shoqëria civile, njerëz që kanë dëshirë të flasin, të tregojnë se çfarë nevojash kanë, njerëz që vijnë nga radhët e profesionistëve të lirë. Ndryshimet e tyre bëhen të reflektueshme në diskutimin nën për nën e në relacionin përmbledhës, i cili i dërgohet Komisionit të Ekonomisë. Tani, sipas kalendarit, ne e kemi si detyrim të miratojmë buxhetin në parim. Vetëm kaq. Dëgjesat për buxhetin vazhdojnë, nuk kanë mbaruar, por në parim i kemi dëgjuar të gjitha institucionet e varësisë.

Fatjona Dhimetri – Ndjesë Milva! Me aq dëgjesa sa janë bërë, të paktën nga trupa e rektorëve të universiteteve publike, kishim mangësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që kishim. Mungonte Universiteti i Gjirokastrës, Universiteti i Durrësit. Nuk kishin asnjë përfaqësues. Madje as relacionet nuk janë dërguar. Do t'i dërgojnë, dakord, për formalitet do t'i dërgojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

U dëgjua Akademia e Shkencave, me një përfaqësues a dy që erdhën. Akademia e Shkencave nuk përfaqësohet vetëm nga një person.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja edhe katër. S'ka lidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po vetëm ata që i interesojnë komisionit do të vijnë? Vetëm ata?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E përcaktojnë vetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai burri është nul për këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, nul është për të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Muhamet, mund të flasësh.

Muhamet Bela – Më falni, paraprakisht dua të jap mendimin tim. Një detyrë që më është ngarkuar mua si këshilltar, ka qenë komunikimi me universitetet e me botën akademike. Ata janë njoftuar si me *e-mail*, ashtu edhe me mesazh, të cilat disponohen. *E-mail*-i është pak a shumë zyrtar.

Në praktikën e punës së komisionit, ftohen institucionet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me buxhetin, që në këtë rast është buxheti i vitit 2020. Akademia është njoftuar, Akademia e Studimeve Albanologjike është njoftuar, edhe universitetet publike janë njoftuar.

Pra, këta të rretheve, që kanë ardhur sot, kanë pritur një orë, se kështu ishte situata, ndërsa profesor Mynyr Koni ka dërguar njoftim në *e-mail*-in tim, gjë për të cilën ju kam njoftuar edhe juve, ku shpjegon se ka të pamundur të vijë. Profesor Mynyri njofton se ka porositur zëvendësrektorin dhe administratorin që të vijnë, gjë për të cilën unë kam komunikuar edhe me relatoren.

Unë i kam bërë shënimet e mia, i kam përcjellë paraprakisht: ju lutem, dërgoni material me shkrim.

Të themi të drejtën, këta të universiteteve, një pjesë kanë arritur të vijnë, por një pjesë kanë edhe problemet e tyre. Gjithsesi insistimi ynë ka qenë i tillë. Na ka munguar vetëm Durrësi, Shkodra. Profesor Ademi sapo komunikoi me telefon. Tha që ka ardhur dje, duke menduar se mbledhja ishte dje. Faktikisht, me shkrim është e shënuar me datë 15, në orën 11.

Tani, në lidhje me institucionet e tjera, sot projektligji votohet në parim, sipas afatit ligjor të përcaktuar në rregullore, si të vjetrës, ashtu edhe të resë. Sepse, një pjesë e juaja nuk do të jetë këtu, kryetarja e nënkryetarja, me sa kam informacion, do të jenë jashtë shtetit, kështu që, detyrimisht ne duhet të paraqesim raportin, për të cilin po punon profesoresha, ish-ministrja Nikolla, në cilësinë e relatores. Duhet edhe firma e kryetares së komisionit. Do të mbarojë raporti, sipas mendimeve që keni. Unë do të jem i gatshëm të punoj edhe natën, me qëllim që ta përfundojmë në afatin e duhur.

Kaq kisha.

Fatjona Dhimitri – Prapë insistoј në faktin se buxheti, qoftë dhe në parim, po kalon shumë shpejt. Ka ardhur shumë vonë në komisionin tonë. Seancat dëgjimore kanë qenë tepër të kufizuara...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po të kufizuara kanë qenë. As juve nuk ju është dhënë mundësia për t'i trajtuar të gjitha ato pyetje që keni për të ftuarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbase ti ke pasur kohë të mjaftueshme...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbyllet pika e katërt e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

5. Miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, *komision për dhënie mendimi.*

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Musa Ulqini, Almira Xhembulla, Fadil Nasufi, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Adelina Rista, Klajdi Qama, Ramazan Gjyzi, Kostaq Papa, dhe Amra Barova.

Mungojnë:

Fidel Ylli, Selami Jenishehri, dhe Enada Kapllani

Vijon pika e fundit e rendit të ditës

Fatjona Dhimitri - Hedhim në votim në parim projektligjin ”Për Buxhetin e Vitit 2020”.

Kush është dakord?

Pro? Kundër?

Me shumicën e votave të komisionit, projektligji miratohet në parim.

Lidhur me seancën e radhës, më datën 24 unë nuk do të jem këtu, sepse kam të dyzetat e babait.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit!

Se si do të veprojmë, do ta shohim gjatë ditëve në vijim. Do të flas edhe një herë me anëtarët e tjerë të kryesisë. Unë e kuptoj që mund ta marrësh edhe ti drejtimin, por mirë është të kemi të pranishëm mendimin e opozitës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta diskutojmë gjatë ditëve në vijim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, patjetër që dua të jem e pranishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

MBYLLET MBLEDHJA

